



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 52 (827750)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 24 Dhjetor 2021

Analiza vjetore e Akademisë së Forcave të Armatosura



Gjeneral brigade Mullai: Fokusi i punës do të jetë i përqendruar te procesi i transformimit rrënjësor të Akademisë

Në ambientet e AFA-së u zhvillua analiza vjetore e Akademisë së Forcave të Armatosura. Të pranishëm në analizë ishin zëvendës Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, Komandanti i AFA-së gjeneral brigade Albert Mullai, komandantët e institucioneve të AFA-së, si

dhe drejtorë nga SHPFA. Komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Albert Mullai, bëri një ekspozë të punës intensive njëvjeçare të Akademisë, arritjeve dhe realizimit të planit arsimor gjatë vitit 2021, i cili kulmoi me licencimin e 3 programeve studimore, procesin e zhvillimit dhe transformimit të AFA-së... >>> faqe 2

SIMBOLE QË TREGOJNË VLERA

Monumentet kulturore, entiteti ynë kombëtar



>>> faqe 6-7

Reformimi i Forcave të Armatosura

Gjeneral Begaj: FARSH histori suksesi, vizion i ri, standard, transformim, arsimim dinjitoz

Intervistë me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Prof. Asoc. Bajram Begaj >>> faqe 4-5



Analiza e FT-së

Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj: Vlerësim maksimal për angazhimin vetëmohues të KFT në emergjencat civile si zjarre dhe përmytje

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj, mori pjesë në analizën vjetore të Komandës së Forcës Tokësore (KFT), ku morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, drejtorë nga SHPFA, komandantët të reparteve të KFT-së dhe shefa të degëve në KFT. Gjeneral brigade Kingji bëri një paraqitje të arritjeve dhe detyrave të realizuara gjatë vitit 2021...



>>> faqe 3

Analiza vjetore e Forcës Ajrore

Mbështetja ajrore në stërvitjet e përbashkëta në kuadër të FA, të emergjencave civile kryesisht për shuarjen e zjarreve nga ajri

Në Garnizonin Rinas, u zhvillua analiza e punës të Forcës Ajrore për vitin 2021, takim në të cilin mori pjesë virtualisht shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj, drejtorët e drejtorive të Shtabit të Përgjithshëm, ndërsa të pranishëm në sallë ishin zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, shefi i shtabit kolonel Arben Cenolli, drejtues të strukturave të Forcës Ajrore... >>> faqe 6

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s

Jens Stoltenberg: Epoka e sferave të ndikimit ka përfunduar

>>> faqe 8



ANALIZA

"Europa e re" nën "kërcënimin e vjetër"

KOLONEL HYSNI GJERGJI

faqe 10-11

HISTORI

Dukuri të artit ushtarak të shfaqura në Luftën e Dibrës 1920-1921

faqe 14

Regjimenti i Operacioneve Speciale zhvilloi analizën vjetore

Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, mori pjesë në analizën vjetore të Komandës dhe Shtabit të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS). Ky aktivitet, i zhvilluar në ambientet e dislokimit të përhershëm të ROS, u hap nga komandanti i këtij reparti, kolonel Arben Zani.

Më tej, prezantimi i materialit të analizës u krye nga shefi i Shtabit të ROS, nënkolonel Edvis Spahi.

Gjeneral Kingji, shprehu falënderimet dhe mirënjohjen e tij për punën dhe sakrificat e efektivëve të ROS gjatë gjithë vitit 2021. Ai vlerësoi me nota pozitive nivelin e profesionalizmit dhe të gatishmërisë së këtyre trupave jo

vetëm në stërvitje, por edhe në operacionet në kuadër të Emergjencave Civile.

Komandanti i Forcës Tokësore, duke i siguruar për mbështetjen e plotë të tij dhe të Shtabit të Forcës Tokësore, komandantin dhe Shtabin e ROS dhe nëpërmjet tyre të gjithë efektivët e këtij regjimenti, kërkoi nga ana e tyre që edhe gjatë vitit të ardhshëm, të vazhdojnë të tregojnë të njëjtin devocion, disiplinë dhe profesionalizëm në realizimin e detyrave dhe sfidave që mund të paraqiten para tyre.

Analiza vijoi më tej me diskutime, në lidhje me arritjet dhe problematikat e hasura gjatë vitit që lamë pas.



Analiza vjetore e Akademisë së Forcave të Armatosura

Gjeneral brigade Mullai: Fokusi i punës do të jetë i përqendruar te procesi i transformimit rrënjësor të Akademisë

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu theksoi se: Akademia e Forcave të Armatosura është në vëmendjen kryesore të saj dhe të gjithë lidershipit të FA

Në ambientet e AFA-së u zhvillua analiza vjetore e Akademisë së Forcave të Armatosura.

Të pranishëm në analizë ishin zëvendës Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, Komandanti i AFA-së gjeneral brigade Albert Mullai, komandantët e institucioneve të AFA-së, si dhe drejtorë nga SHPFA. Komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Albert Mullai, bëri një ekspozë të punës intensive njëvjeçare të Akademisë, arritjeve dhe realizimit të planit arsimor gjatë vitit 2021, i cili kulmoi me licencimin e 3 programeve studimore, procesin e zhvillimit dhe transformimit të AFA-së, vizionin dhe projeksionin se ku po shkon Akademia, nënshkrimin e pesë marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitetet brenda dhe jashtë vendit, angazhimin dhe koordinimin brenda Akademisë dhe institucioneve të saj në përballimin e kurseve të paplanifikuara mbi kapacitetet si dhe organizimin e dy konferencave shkencore nga Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak.

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu vlerësoi maksimalisht punën e bërë dhe përgëzoi për punën dhe arritjet e AFA-së në kushte të vështira, pavarësisht problematikave dhe vështirësive për përmbushjen me sukses të misionit të saj.

Gjithashtu, gjeneralmajor Shehu theksoi se: "Akademia e Forcave të Armatosura është në vëmendjen kryesore të saj dhe të gjithë lidershipit të Forcave të Armatosura, si dhe rikonfirmoi mbështetjen maksimale të tyre për krijimin e një Akademie dinjtoze, që do të formojë liderët e ardhshëm në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes".

Në mbyllje të analizës, Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura gjeneral brigade Mullai, ritheksoi se: "Në të ardhmen fokusi i punës do të jetë i përqendruar kryesisht tek procesi i transformimit rrënjësor të



Akademisë në një institucion modern sipas modelit të Akademisë Ushtarake të "West Point"-it të SHBA-së si dhe krijimi i një Kolegji Profesional Mbrojtje, ku do të përgatiten oficerët e të gjitha niveleve të drejtim komandimit të FA-së dhe të institucioneve të tjera të sigurisë jo vetëm të Shqipërisë por e gjithë rajonit e më gjerë.

Ky projekt ambicioz tashmë ka marrë miratimin e qeverisë e të Ministrisë së Mbrojtjes dhe po materializo-

het. Struktura e re, sipas modelit amerikan, një infrastrukturë moderne e materializuar në ndërtimin e një kampusi krejtësisht të ri dhe modern, kurrikula bashkëkohore e një baze moderne didaktike, kërkim shkencor bashkëkohor me synim inovacionin do jenë fytyra e re e këtij institucioni i cili do jetë vatra ku përgatiten liderët e ardhshëm të FA-së por njëkohësisht edhe qendra ku prodhohet e përpunohet mendimi më i përparuar shkencor lidhur me Sigurinë dhe Mbrojtjen".

Takimi u mbyll me urimin e Tij për të gjithë personelin e AFA-së me rastin e festave të fund-vitit.





Gjeneralmajor Prof. Asoc. Begaj vlerësoi punën dhe arritjet e KFT për vitin 2021, sidomos në drejtim të pjesëmarrjes së lartë në stërvitje brenda dhe jashtë vendit, ku ndër më të spikaturat ishte stërvitja “Defender Europe 21”.

Analiza vjetore e Komandës së Forcës Tokësore

Gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj: Vlerësim maksimal për angazhimin vetëmohues të KFT në emergjencat civile si zjarre dhe përmbytje

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj, mori pjesë në analizën vjetore të Komandës së Forcës Tokësore (KFT), ku morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore gjeneralbrigade Arben Kingji, drejtorë nga SHPFA, komandantë të reparteve të KFT-së dhe shefa të degëve në KFT.

Gjeneralbrigade Kingji bëri një paraqitje të arritjeve dhe detyrave të realizuara gjatë vitit 2021, ku më të spikatura ishin aktivitetet stërvitore, kalimi në strukturën e re si dhe angazhimi në operacionet në mbështetje të popullsisë dhe emergjencave civile.

Ndërsa gjeneralmajor Prof. Asoc. Begaj vlerësoi punën dhe arritjet e KFT për vitin 2021, sidomos në drejtim të pjesëmarrjes së lartë në stërvitje brenda dhe jashtë vendit, ku ndër më të spikaturat ishte stërvitja “Defender Europe 21”. Gjithashtu, vlerësoi angazhimin vetëmohues të personelit të KFT-së në emergjencat civile si zjarre e përmbytje, angazhim i cili u vlerësua edhe nga kryeministri i vendit z. Edi Rama.

Kalimi në mënyrë profe-



sioniste në strukturën e re dhe arritja e kapaciteteve të plota operacionale për të gjitha nën-repartet ishte gjithashtu fokus i analizës vjetore.

SHSHP ritheksoi edhe njëherë prioritetet e tij të shpallura në vizionin e SHSHP të FARSH, duke nënvizuar rëndësinë e përbushjes së objektivave për grup-batalionin e Këmbësisë, i cili pritet të kalojë vlerësimin e NATO-s gjatë 2022.

Në kuadër të masave kundër Covid-19 por edhe mbështetjes shëndetësore, Qendra Shëndetësore e KFT-së organizoi një mësim tregues me kapacitetet e tyre shëndetësore, për të treguar gatishmërinë dhe kapacitetet për të mbështetur aktivitetet dhe misionin e KFT-së, por jo vetëm.

Në fund gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj, uroi të gjithë personelin e Forcës Tokësore për festat e fund-vitit.

Gjeneral Begaj: FARSH histori sukcesi, vizion i ri, standard, transformim, arsimim dinjitoz

Në harkun kohor të 109 viteve Ushtri Shqiptare, gjeneral Begaj është lideri i 26 -të, nën drejtimin e të cilit ushtria jonë me një histori të lashtë por me vizion të ri, po transformohet në standardet e ushtrive të vendeve aleate të NATO-s, pjesë e së cilës prej vitit 2009 jemi dhe ne.

I nderuar gjeneral Begaj!

Cili është vizioni juaj mbi transformimin dhe reformimin e Forcave të Armatosura?

E vlerësoj këtë pyetje, që më jep mundësinë të shpreh thelbin e angazhimit tim si Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Do ta filloja duke theksuar se një vizion i ardhshëm dhe i ri për forcën ushtarake të vendit si anëtar i NATO-s ngrihet dhe konturohet mbi bazën e gjendjes dhe situatës aktuale që ato kanë. Forcat e Armatosura aktuale janë kontribut, punë, djersë, sakrificë dhe dije të shumë brezave ushtarakësh që kanë shërbyer në vite dhe të atyre që shërbejnë sot. Unë e shfrytëzoj këtë rast që të shpreh respektin dhe nderimin e sinqertë për ata që janë në rezervë e lirim dhe për të gjithë ata që janë aktiv, për atë çka kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë. Sigurisht që këtu përfshihet edhe personeli civil që ka punuar e punon në strukturat ushtarake. Krahas kësaj, mbajtja, zhvillimi dhe modernizimi i Forcave të Armatosura është në një masë të madhe efekt dhe rezultat i ndikimeve të një kompleksi të integruar faktorësh dhe aktorësh të brendshëm kombëtar por natyrisht edhe të jashtëm. Një nga faktorët e jashtëm permanent është anëtarësia në NATO. Aleanca në Samitin e fundit në Bruksel miratoi vizionin NATO 2030. Shqipëria është pjesë e këtij sistemi të sigurisë dhe mbrojtjes kolektive, dhe kjo padyshim që do të përcaktojë në një shkallë të konsiderueshme masën dhe natyrën e kapaciteteve ushtarake të vendit dhe rrjedhimisht edhe të vizionit për Forcat e Armatosura. Sigurisht që Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, në gjithë këtë mori aktorësh dhe faktorësh, ka rolin dhe përgjegjësinë e tij në konfigurimin dhe ndërtimin e vizionit të Forcave të Armatosura.

Në këtë kuadër, puna e SHSHP do të orientohet në harmonizimin e përpjekjeve të përbashkëta, për të pasur një forcë efektive dhe të aftë për t'u përgjigjur sfidave dhe kërcënimeve të së ardhmes, në përbushje të misionit kushtetues dhe detyrimeve në interes të Aleancës. Në drejtimin e të gjithë aktorëve të zinxhirit të komandimit, reformimi i FARSH do të vijojë si proces i përhershëm transformimi për krijimin e një force profesioniste të motivuar dhe të përgatitur, të vogël por të pajisur mirë, ku njëherazi do të vijojë përbushja e misioneve të së sotmes, forcimi i kohezionit dhe përbashkimi i sfidave të së ardhmes. Transformimi do të synojë që në vitin 2023, FARSH të jenë të mirë-pajisura, të gatshme, të stërvitura, të dislokueshme, të ndërveprueshme, modulare dhe të mbështetura për të vepruar në mëvetësi. FARSH do të garantojnë sovranitetin kombëtar, do të përballojnë katastrofat natyrore dhe emergjencat civile, do të rrisin angazhimin në komunitet dhe do të vijojnë mbështetjen e Aleancës në mbrojtjen kolektive, menaxhimin e krizave dhe bashkëpunimin për sigurinë. Rishikimi i dokumenteve strategjike, SU dhe PAZH; përmirësimi i legjislativit,

● *Intervistë me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Prof. Asoc. Bajram Begaj*



ndryshimi i tabelës së organizimit dhe pajisjeve do të jenë busull për të orientuar transformimin e FARSH, në garantimin e sigurisë dhe përbashkësinë e skenarëve të kërcënimeve. Transformimi i FA do të sigurojë që procesi i planifikimit të jetë në harmoni me atë të Aleancës dhe të reflektojë ndryshimet e mjedisit të sigurisë, rreziqet e kërcënimit

Sigurisht, angazhimi i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm për kryerjen me sukses të detyrës është i gjerë dhe i shumanshëm por fokusi i vëmendjes time për këtë periudhë 2020-2023 do të jenë:

1) Zhvillimi i kapacitetit të GBKL, sipas paketës së Objektivave të Kapaciteteve të NATO-s.

2) Implementimi i sistemit të ri për arsimin e lartë ushtarak për kandidatët, për Oficerë dhe nënoficerë.

3) Zhvillimi i kapaciteteve të plota (krijimi si strukture e Bazës së mbrojtjes civile) për përbashkësinë e emergjencave civile, sipas ligjit për Mbrojtjen Civile në RSH dhe katastrofave natyrore.

4) Përmirësimi i sistemit të rekrutimit, përkujdesjes dhe promovimit të ushtarakëve.

Ky vizion parashtron dëshirën për t'i shërbyer vendit dhe FARSH, i orientuar nga Kushtetuta e RSH dhe objektivat e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Strategjisë Ushtarake, Planit Afatgjatë të Zhvillimit të FARSH dhe me ndjenjën e përgjegjësisë për detyrimet e vendit në kuadër të mbrojtjes kolektive të Aleancës. Vizioni që ju paraqitet, mbështetet tek besimi se profesionalizmi, përvoja dhe ekspertiza, do të rrisë energjitë dhe përforcijnë vullnetin, për përmirësimin e organizimit, pajisjes, gatishmërisë dhe motivimit të FARSH, për t'u përgjigjur rreziqeve dhe kërcënimeve të së sotmes dhe të së ardhmes.

Drejtimi i Forcave të Armatosura sipas një vizioni të tillë sigurisht që është sfidë, por institucioni i Shefit të Shtabit është një ekip profesionistësh, për të cilin punon Shtabi i Përgjithshëm dhe

pastaj një ekip i tërë i komandantëve të komandave dhe drejtuesve të strukturave ushtarake në terren. Unë kam besim tek profesionalizmi, ndershmëria dhe përkushtimi i të gjithë këtij personeli. Forca e Armatosur është dhe funksionon si një skuadër, unike, kohezive, që me vullnetin dhe frymën që e karakterizon, më jep sigurinë se do ta realizojmë këtë vizion. Me këtë besim, ju siguroj për përkushtimin tim pa rezerva për të përbushur të gjitha përgjegjësitë e postit të lartë.

A ka një strategji për zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore të FA-së?

Padyshim që po. Është miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 246, datë 24.02.2020, "Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2020-2024 (SMBNJ).

➤ SMBNJ është një nga dokumentet kryesore për menaxhimin e burimeve njerëzore në FARSH, i cili përcakton drejtimet strategjike për të mbështetur FA-në me burime njerëzore për një periudhë afatmesme, orientuar nga prioritetet dhe drejtimet kryesore që ka përcaktuar PAZHFA 216-2025 dhe RSM-2019.

➤ Kjo strategji adreson drejtimet kryesore të zhvillimit të burimeve njerëzore të FA-së për periudhën 2020-2024.

➤ Përcakton mënyrën e përmirësimit të të gjithë ciklit jetësor të menaxhimit të burimeve njerëzore në FA.

➤ Është pjesë integrale e strategjisë, politikave, planifikimit dhe menaxhimit të përgjithshëm të të gjitha burimeve të mbrojtjes, për zbatimin e politikave dhe direktivave të Ministrit të Mbrojtjes.

➤ Synimi kryesor i SMBNJ 2020-2024 është përmirësimi dhe konsolidimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, me qëllim rritjen e efikasitetit të sistemit, në mbështetje

të FA-së.

Cila është qasja mbi zhvillimin e kapaciteteve dhe modernizimin e FARSH?

Modernizimi i FARSH është një nga përgjegjësitë kryesore të SHSHP, për të zhvilluar dhe përmirësuar kapacitetet, për plotësimin e misionit kushtetues, detyrimeve ligjore dhe atyre në kuadër të NATO-s. Forca të Armatosura të pajisura, strukturuara, trajnuara dhe mbështetura me burime, do të garantojnë sovranitetin deri në aktivizimin e burimeve të tjera kombëtare apo aktivizimin e Nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit. Në vitet 2020-2023, do të intensifikohet modernizimi i FA-së, duke investuar në sisteme, pajisje dhe infrastrukturë. Prioritet do të jetë forca tokësore, me fokus grup-batalionin e këmbësorisë së lehtë, elementët e tij mbështetës dhe njësitë e tjera të deklaruara në NATO.

Nisur nga parimi i një seti të vetëm forcash, batalioni i dytë i këmbësorisë, si elementi kyç i grup-batalionit, krahas plotësimit me personel dhe intensifikimit të stërvitjes, do të kompletohet me pajisje, armatim dhe teknikë, për rritjen e fuqisë së zjarrit, lëvizshmërisë dhe mbrojtjes së trupave, për të qenë i gatshëm për pjesëmarrjen në operacionet e Aleancës.

Programet e modernizimit në FARSH, do të përmirësojnë armatimin e lehtë, pajisjet individuale të ushtarit, mbështetjen me zjarr indirekt, sistemet e komunikimit taktik, pajisjet e zbulimit, pajisjet speciale për kushte ekstreme moti dhe terreni, pajisjet mjekësore dhe pajisjet e mbrojtjes individuale e kolektive ndaj ADM, krahas investimeve në infrastrukturën e jetesës dhe stërvitjes.

Kompletimi i njësitë të deklaruara në NATO, me sisteme të ndërveprueshme identifikimi, do të ecë paralel me përmirësimin e kapaciteteve të kërkuara për vëzhgimin e hapësirës tokësore (përfshi

sistemet e fluturimit pa pilot (UAV), detare dhe ajrore të RSH, për të garantuar monitorimin e hapësirës, sigurinë e informacionit, transmetimin e të dhënave dhe menaxhimin e dokumenteve, në përputhje me zhvillimet teknologjike. Forca Detare (FD) zotëron kapacitetet e nevojshme për kryerjen e operacioneve, në funksion të misionit kushtetues të FARSH, të rojës bregdetare dhe në kuadrin e Aleancës. Këto kapacitete do të përmirësohen për të siguruar prezencën e FD-së në gjithë vijën bregdetare monitorimin dhe reagimin e duhur, për të garantuar sovranitetin dhe ligjshmërinë në det. Kontrolli i hapësirës detare, si interes kombëtar, kërkon përmirësimin dhe rinovimin e sistemeve të vëzhgimit (SIVHD), transmetimit të informacionit dhe identifikimit të anijeve duke siguruar mbulimin e hapësirës detare dhe shkëmbimin e situatës me Aleancën.

Forca Ajrore (FAJ) do të modernizohet dhe fuqizohet me helikopterë "Black Hawk", dhe "Ground Based Air Defence" (GBAD). Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore (SIVA) do të vijojë të integrohet në Sistemin e Integruar të Mbrojtjes Raketore dhe Ajrore të NATO-s (NATINAMDS), për të siguruar vëzhgim të pandërprerë dhe shkëmbimin e pamjes ajrore për vendin dhe Aleancën. Gjithashtu, do të përmirësohen sistemet e komunikimit tokë-ajër-tokë, pajisjet speciale për ekui-pazhet fluturuese dhe për mirëmbajtjen e helikopterëve. Forca Ajrore do të ndjekë dhe koordinojë zbatimin e projektit të NATO-s, për shndërrimin e Bazës Ajrore në Kuçovë në një Bazë të Dislokueshme Taktike në dispozicion të NATO-s, por edhe për përdorim kombëtar.

Modernizimi i FA-së është fokusuar në zhvillimin e kapaciteteve të kërkuara për t'u përballuar me sfidat e mjedisit të sigurisë, ku prioritet i është dhënë: Modernizimit të sistemeve dhe pajisjeve të Grup batalionit të lehtë të këmbësorisë - GBKL (sistemet e mbështetjes me zjarr, sistemet e zbulimit taktik); Grupit për detyrë të operacioneve speciale - SOLTG; Pajisjeve të komunikimit taktik të dislokueshëm; Njësisë Ushtarake të Mbrojtjes Kibernetike; Armatimit të lehtë dhe municioneve; Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore (SIVHA); Përmirësimit të softit të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD); Sistemit të mbrojtjes ajrore të bazuar në tokë (GBAD); Sistemit të komunikimit Tokë-Ajër-Tokë; Sistemeve të mbrojtjes e vetëmbrojtjes së helikopterëve; Zëvendësimit të telefonave satelitorë dhe pajisjeve TacSat; Modernizimit të SNI-së; Pajisjeve për togën EOD; Modernizimit të mjeteve taktike të transportit dhe atyre speciale, kërkim- shpëtim, speciale xheniere etj.

Cilët janë hapat që janë ndjekur për përmirësimin e sistemit të rekrutimit, përkujdesjes dhe promovimit të ushtarakëve?

Për rekrutimin:

➤ Rishikuar dhe miratuar ligji nr.15/2021, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.59/2014 "Për

Analiza vjetore e Forcës Ajrore

Në Garnizonin Rinas, u zhvillua analiza e punës e Forcës Ajrore për vitin 2021, takim në të cilin mori pjesë virtualisht shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Prof. Asoc. Bajram Begaj, drejtorët e drejtorive të Shtabit të Përgjithshëm, ndërsa të pranishëm në sallë ishin zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, shefi i shtabit kolonel Arben Cenolli, drejtues të strukturave të Forcës Ajrore si dhe shefa kryesorë në shtabin dhe Komandën e Forcës.

Gjeneral Pulaj pasi falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm për mbështetjen e vazhdueshme për Forcën Ajrore dhe prezencën e tij virtuale në këtë analizë vjetore së bashku me stafin, përmendi në mënyrë thelbësore disa nga arritjet e Forcës Ajrore duke ia lënë fjalën më tej shefit të Shtabit të Forcës Ajrore, kolonel Cenolli, për të prezantuar në tërësi arritjet, aktivitetet kryesore të realizuara nga strukturat gjatë vitit 2021 si dhe rrugën për të ardhmen.

Kolonel Cenolli në prezantimin e tij u ndal tek prioritetet dhe aktivitetet e Forcës Ajrore si dhe pjesëmarrja në operacionet ajrore dhe mbështetja ajrore në stërvitjet e përbashkëta në kuadër të Forcave të Armatosura, të emergjencave civile kryesisht për shuarjen e zjarreve nga ajri por edhe stërvitjet e tjera në interes të rritjes së kapaciteteve operacionale të strukturave të Forcës Ajrore siç ishte Stërvitja "Defender Europe-21", "Ambicia e Shqiponjës" apo kursi bazë i oficerit "Pilot Ushtarak Helikopteri" etj. Në këtë panoramë të punës njëvjeçare, u përmendën gjithashtu edhe disa problematika të shoqëruara edhe me zgjidhjet e mundshme për në vazhdim.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm në fjalën e tij, falënderoi për prezantimin dhe stafin për punën njëvjeçare të Forcës Ajrore, duke vënë theksin se, nëpërmjet mirëkuptimit, mirëkoordinimit dhe bashkëpunimit, realizojmë objektivat dhe rrisim operacionalitetin e Forcës, si dhe siguroi se, do të vazhdojë të mbështesë Forcën Ajrore në vazhdimësi për realizimin e objektivave. Në përfundim të fjalës së tij, gjeneralmajor Begaj uroi festa të gëzuara dhe shëndet më mirë për të gjithë pjesëmarrësit dhe personelin e Forcës Ajrore. Në mbyllje të analizës, gjeneral brigade Pulaj falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm për mbështetjen që ai personalisht dhe ministri i Mbrojtjes i kanë dhënë Forcës Ajrore gjatë vitit 2021 duke u shprehur se, sugjerimet e dala nga kjo analizë do të përkthehen në plane e programe pune për realizimin e objektivave gjatë vitit 2022. Gjithashtu ai adresoi një falënderim të veçantë për pjesëmarrësit në takim, për punën dhe përkushtimin e tyre gjatë vitit 2021, si dhe uroi një vit të mbarë në aspektin familjar dhe profesional.

Mbështetja ajrore në stërvitjet e përbashkëta në kuadër të FA, të emergjencave civile kryesisht për shuarjen e zjarreve nga ajri



Kolonel Cenolli në prezantimin e tij u ndal tek prioritetet dhe aktivitetet e Forcës Ajrore si dhe pjesëmarrja në operacionet ajrore dhe mbështetja ajrore në stërvitjet e përbashkëta në kuadër të Forcave të Armatosura, të emergjencave civile kryesisht për shuarjen e zjarreve nga ajri por edhe stërvitjet e tjera në interes të rritjes së kapaciteteve operacionale të strukturave të Forcës Ajrore siç ishte Stërvitja "Defender Europe-21"

Insituti Kërkimor Shkencor ushtarak zhvilloi analizën vjetore

Gjatë këtij aktiviteti të rëndësishëm vjetor u trajtua veprimtaria e zhvilluar si dhe realizimet kryesore të IKSHU-së për vitin 2021, të planëzuar sipas katër fushave kryesore të përgjegjësisë që mbulon ky institucion: Studime në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare, Mbështetja e FARSH-së me publikime Doktrinare; Mundësimi i stërvitjeve me simulim të FARSH-së; Standardizim dhe Mësime të nxjerra, si dhe projekte të tjera kërkimore shkencore për fusha të ndryshme interesi.

Gjatë analizës u evidentua dhe u theksua fakti i zhvillimit me sukses të 14 studimeve të përmbledhura në një "Cikël studimesh shkencore të IKSHU-së për vitin 2021", të dy Konferencave Shkencore, publikimi i dy cikleve me studime si produkt i konferencës shkencore, dy edicione të "Revistës ushtarake", realizimi i tre doktrinave dhe disa manualeve. Gjithashtu u evidentua edhe mbështetja e 8 stërvitjeve me simulim, të FARSH, ndërinstitucionale, kombëtare dhe rajonale. Një fokus të veçantë gjatë analizës iu kushtua prioritetëve dhe objektivave të IKSHU-së gjatë vitit 2022, ku u theksua nevoja e transformimit dhe konsolidimit të strukturës në përputhje me orientimet e strukturave eprore dhe të përmushjes sa më mirë të misionit dhe detyrave themelore.



Gjatë analizës u evidentua dhe u theksua fakti i zhvillimit me sukses të 14 studimeve të përmbledhura në një "Cikël studimesh shkencore të IKSHU-së për vitin 2021", të dy Konferencave Shkencore, publikimi i dy cikleve me studime si produkt i konferencës shkencore, dy edicione të "Revistës ushtarake", realizimi i tre doktrinave dhe disa manualeve. Gjithashtu u evidentua edhe mbështetja e 8 stërvitjeve me simulim, të FARSH, ndërinstitucionale, kombëtare dhe rajonale.

Simbole që tregojnë vlera

Monumentet kulturore, entiteti ynë kombëtar

Shefe e sektorit të Botimeve
ANJEZA MUSOLLARI

Monumentet e kulturës së një qyteti e kombi janë simbole të rëndësishme që tregojnë vlerat materiale, shpirtërore dhe zhvillimin në shekuj dhe vite. Monumentet e kulturës jo vetëm në perëndim, por edhe në vendet ish-komuniste kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë një vëmendje të veçantë. Prandaj duhet që këto institucione shpirtërore dhe materiale të një kombi të marrin vendin që iu takon, të bëhen të vlefshëm deri të shenja për të gjithë ne!

Është pikërisht trashëgimia kulturore materiale por edhe ajo shpirtërore që nxit sot një pjesë të mirë të turizmit të brendshëm por edhe atij të huaj për të eksploruar vende dhe objekte, parqe arkeologjike e qytete antike e mesjetare që ruajnë shenja të genësishme të së kaluarës, të reflektuara në monumente e objekte të arrira artistikisht, arkitektonikisht e estetikisht tërheqëse. Monumentet e kulturës janë të periudhave të ndryshme, relativisht të mbrojtura mirë nga koha por edhe me nevoja restaurimi e përmirësimi në disa syresh, duke ofruar larmishmëri në eksperiencë, por ajo që është më e rëndësishme, të ofrohet mundësia për të njohur nga afër jetën e banorëve, traditat e tyre shekullore dhe qëndrimin në banesa karakteristike të zonës. Trashëgimia kulturore materiale është pasuri e brezave, detyrim madhor i tyre kundrejt së shkuarës dhe së ardhmes, vijimësi materiale e çdo kombi. Si e tillë, trashëgimia kulturore materiale është një sfidë e pareshtur përballë kujdesit kombëtar e ndërkombëtar, për të arritur gjurmët e gjenit krijuar mbarë-shekullor dhe për ta përcjellë atë drejt së ardhmes, tek brezat e rinj.

Trashëgimia kulturore është një realitet dinamik sepse është një tërësi e hapur dhe jo e mbyllur dhe si e tillë jo definitive, por gjithnjë në zgjerim, sepse ajo vijon të jetë pjesë e gjetjeve të vazhdueshme përgjatë kërkimeve në fushën e historisë së artit dhe arkitekturës, arkeologjisë, dokumentacionit arkivor dhe bibliografik, të cilat nuk ndërpriten kurrë. Trashëgimia kulturore është para së gjithash dëshmi materiale me vlerën e qytetërimit të përbotshëm, natyrisht kur ai gjendet brenda territorit shqiptar, është pjesë e qytetërimit përkates. Qytetërimi, historia dhe kultura na bëjnë të kujtojmë se trashëgimia historike e artistike: monumentet, arkeologjia, arkivat, bibliotekat, peizazhet mjedisore, veprat artistike të prodhuara nga njeriu etj., kanë një vlerë të njohur artistike, të papërsëritshme e që e përcjellin atë përmes një konotacioni të fortë estetik dhe ekspresiv njëherësh dhe si të tillë ata i përkasin



kulturës dhe bashkësisë që i ka prodhuar, ruajtur e kultivuar si një dëshmi historike autentike e unike njëherësh.

Trashëgimia kulturore dhe natyrore si trashëgimi pa kufi përmes bukurisë dhe vlerave të spikatura artistike, variacioneve të llojeve dhe monumenteve të rëndësishëm të kulturës e natyrës, në thelbin e saj përfshin edukimin tonë me një kulturë qytetare mbarë-evropiane dhe ndërkohë formon drejt krijimin e personalitetit si qytetarë të botës. Trashëgimia kulturore ndikon edhe në forcimin e ndjenjës së identitetit kulturor, në rritjen e respektit dhe promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore, integrimin e trashëgimisë sonë në jetën bashkëkohore të Shqipërisë dhe të shqiptarëve, si dhe në përkujtimin e veprës dhe jetës së personaliteteve të shquara të trashëgimisë dhe të gjithë atyre artistëve anonimë që i krijuan këto vlera ndër shekuj.

Shqipëria është një vend i vogël por me pasuri kulturore, natyrore e shpirtërore të mëdha. 7 prej tyre janë futur nga UNESCO në fondin e trashëgimisë botërore.

1. BUTRINTI

Rrënojat 2500-vjeçare të Butrintit, brenda një parku madhështor të gjelbër e me një hapësirë prej 30 km, janë disa

nga më të bukurat e të mirëmbajturat në Europë. Teatri i shekullit të III-të para Krishtit, Tempulli i Eskulapit (shek. I-II), perëndisë antike të shëndetit, dhe mozaiku me 69 medaljone kishtarë, janë vetëm tre prej kryeveprave të Butrintit.

2. GJIROKASTRA

Qyteti i gurtë njihet jo më pak edhe për panoramën e tij malore, e cila e rrethon Gjirokastrën në tërësi. E sikur të duhej më tepër, në rrethinat e Gjirokastrës gjenden qytetet e bukura antike të Antigonesë dhe Adrianopolit si edhe disa bukuri të rralla natyrore si Liqeni i Viroit dhe Kanioni i Lengaricës ndër shumë të tjera.

3. BERATI

Arkitektura e veçantë e qytetit, e ka pozicionuar Beratin si një nga vendet e Trashëgimisë Botërore sipas UNESCO-s, në Shqipëri. I ndarë në dy lagje historike, Mangalemin dhe Goricën, nga lumi Osum, qyteti bashkohet përmes urës së gurtë të Goricës. Ky qytet, një herë e një kohë i quajtur Antipatrea, është i rrethuar nga Tomori dhe Shpiragu, dy nga malet më mitike të Shqipërisë.

Ai gjithashtu për nga rëndësia e tij, që kishte gjatë pushtimit romak në shekullin II-të para Krishtit, u emërtua

edhe si “Fortesa e Arbërve”.

4. KODIKËT E BERATIT

“Kodiku i Purpurt i Beratit” është një dorëshkrim mjaft i rëndësishëm për fillimet e shkrimeve Biblike. Duke gjykuar nga teknika e shkrimit mendohet se ai është shkruar në shekullin e VI-të p.e.s. Gjithsej ka 190 fletë, të shkruara me shkronja të derdhura në argjend. Bukurshkrimi është i veçantë ndërsa geramat janë të mëdha. Ai përmban dy ungjij: sipas Mateut dhe sipas Markut. Lënda e dorëshkrimit është pergamenë në ngjyrë të kuqe të thellë (purpurtë) prej nga ka marrë edhe emrin. Pjesë të tjera të rëndësishme të kodikut janë të derdhura në ar. Kapaku i dorëshkrimit është më i vonshëm se vepra, ai është metalik dhe me zbukurime skenash biblike.

5. LIQENI I OHRIT

Liqeni i Ohrit u shpall trashëgimi botërore dhe është mbrojtur nga UNESCO. Është një nga liqenet më të thella dhe më të vjetra në Evropë, me më shumë se 200 specie endemike. E vërteta në lidhje me vjetërsinë e liqenit, i cili në agim duket sikur posa ka lindur me mëngjesin, qëndron në gjurmët e jetës së lashtë në fundin e ujërave të tij.

6. LUMI I GASHIT

Me një sipërfaqe prej 3 mijë hektarë, Lumi i Gashit shtrihet në pjesën lindore të Alpeve Shqiptare, duke u kufizuar në veri me Malin e Zi dhe në veri-lindje me Kosovën.

Pjesa më e madhe e sipërfaqes së Lumit të Gashit është thujse tërësisht e mbuluar me pyje të virgjëra ahu dhe pjesa tjetër me pyje halorë si Pinus heldreichii, Abies Alba, Pinus sylvestris, Pinus peuce. Rrjedha e pandalshme e shumëvjeçare e ujit të këtij lumi e ka ndihmuar botën e gjallë të lulëzojë dhe të marrë jetë nga ai.

7. RRAJCA

Një fshat i cili cilësohet me një pasuri kulturore të rrallë, aty ku legjendat e Skënderbeut të shoqërojnë në çdo cep të tij. Ky fshat quhet Rrajcë-Skënderbe. Historia e luftës së përgjakshme të Torviollit, më 29 qershor të vitit 1444, e cila vuri përballë Skënderbeun me gjeneralin e njohur turk Ali Pasha. Sipas gojëdhënave dhe historianëve thuhet se ai e preu me shpatë shkëmbin duke i hapur rrugë ushtrisë së tij, si dhe për t'i bërë kurthin ushtrisë turke. U vranë aq shumë ushtarë sa që u deshën plot tri vjet që trupat e tyre të kalbeshin. Që prej asaj kohe ai u emërua si “Fshati i Skënderbeut”.

Situata në dhe rreth Ukrainës në agjendën e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Këshilli i Atlantikut të Veriut, në deklaratën e orëve të vona të mbrëmjes së datës 16 dhjetor 2021, tha se NATO është shumë e shqetësuar lidhur me situatën në Ukrainë dhe rreth saj. Por NATO tha gjithashtu se është “gati për dialog kuptimplotë” me Rusinë.

“Ne jemi shumë të shqetësuar nga përforsimi i konsiderueshëm, i paprovokuar dhe i pajustificuar ushtarak rus në kufijtë e Ukrainës në muajt e fundit dhe hedhim poshtë pretendimet e rreme ruse për provokimet e Ukrainës dhe NATO-s. Ne i bëjmë thirrje Rusisë që menjëherë të de-përshkallëzojë, të ndjekë kanalet diplomatike dhe të respektojë angazhimet e saj ndërkombëtare për transparencën e aktiviteteve ushtarake”, thuhet në hyrje të deklaratës të NATO-s. “Ne jemi duke vlerësuar seriozisht implikimet për sigurinë e Aleancës të situatës aktuale. Ne gjithmonë do t’i përgjigjemi në mënyrë të vendosur çdo përkeqësimi të mjedisit tonë të sigurisë, përfshirë forcimin e qëndrimit tonë të mbrojtjes kolektive sipas nevojës. NATO do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e të gjithë aleatëve të NATO-s. Çdo agresion i mëtejshëm kundër Ukrainës do të kishte pasoja masive dhe do të kishte një çmim të lartë. NATO do të vazhdojë të koordinohet ngushtë me palët përkatëse të interesit dhe organizata të tjera ndërkombëtare, përfshirë BE-në”, -thuhet më tej në deklaratë.

“Ne përsërisim mbështetjen tonë për integritetin territorial dhe sovranitetin e Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht dhe i bëjmë thirrje Rusisë që të tërheqë forcat e saj nga Ukraina në përputhje me detyrimet dhe angazhimet e saj ndërkombëtare. Ne mbështesim të drejtën e të gjitha vendeve për të vendosur vetë për të ardhmen dhe politikën e tyre të jashtme pa ndërhyrje të jashtme. Marrëdhëniet e NATO-s me Ukrainën janë çështje vetëm për Ukrainën dhe 30 aleatët e NATO-s”, -citen deklarata. “Ne refuzojmë me vendosmëri çdo përpjekje për të përçarë sigurinë aleate. Jemi gati për dialog kuptimplotë me Rusinë. Ne përsërisim ftesën tonë të kahershme drejtuar Rusisë për një takim të Këshillit NATO-Rusi në të ardhmen e afërt. Ne jemi të vetdijshëm për propozimet e fundit të Rusisë për sigurinë evropiane. Ne jemi të qartë se çdo dialog me Rusinë duhet të vazhdojë në bazë të reciprocitetit, të adresojë shqetësimet e NATO-s për veprimet e Rusisë, të bazohet në parimet thelbësore dhe dokumentet themelore të sigurisë evropiane dhe të bëhet në konsultim me Partnerët

Jens Stoltenberg: Epoka e sferave të ndikimit ka përfunduar



Evropianë të NATO-s. Nëse Rusia merr hapa konkretë për të ulur tensionet, ne jemi të përgatitur të punojmë për forcimin e masave të ndërtimit të besimit. OSBE-ja është gjithashtu një platformë përkatëse. NATO është një Aleancë mbrojtëse dhe do të vazhdojë të përpiqet për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në të gjithë zonën euroatlantike. Ne qëndrojmë të bashkuar për të siguruar dhe mbrojtur të gjithë aleatët”, -përfundon deklarata e Këshillit të Atlantikut të Veriut mbi situatën në Ukrainë dhe rreth saj.

Rumania, rol thelbësor në rajonin e Detit të Zi

Grumbullimet ushtarake të Rusisë në dhe rreth Ukrainës, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s i diskutoi gjithashtu gjatë kësaj jave, me Kryeministrin e Rumanisë, Nicolae Ciucă, në selinë e NATO-s, në takimin e zhvilluar më 21 dhjetor 2021. Z. Stoltenberg vlerësoi kontributet e Rumanisë në Aleancë dhe luajtjen e një roli thelbësor në rajonin e Detit të Zi. Ai përshëndeti përpjekjet e Rumanisë për të ndihmuar në ndërtimin e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor dhe mbështetjen e saj për partnerët e NATO-s, si Mol-

davia dhe Ukraina. “Rumania është një aleat i besueshëm dhe i përkushtuar i NATO-s dhe luan një rol thelbësor në sigurinë e Detit të Zi, përfshirë brigadën shumëkombëshe të udhëhequr nga Rumania në Krajova, policimin ajror dhe dislokimet detare. Ju ndihmoni për të penguar agresionin si pjesë e grupit tonë të betejës shumëkombëshe në Poloni”, -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në deklaratën para medieve me Kryeministrin e Rumanisë. “Ju ndihmoni në ndërtimin e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor përmes misionit tonë paqeruajtës të KFOR-it dhe ju mbështesni partnerët tanë, përfshirë Moldavinë dhe Ukrainën. Rumania gjithashtu udhëheq me shembull kur bëhet fjalë për investimet në mbrojtje”, -tha ai. “Ne mbetemi të gatshëm për dialog kuptimplotë me Rusinë dhe kam ndërmend të thërras një takim të ri të Këshillit NATO-Rusi sa më shpejt të jetë e mundur në Vitin e Ri. Çdo dialog me Rusinë duhet të bazohet në parimet thelbësore të sigurisë evropiane dhe të adresojë shqetësimet e NATO-s për veprimet e Rusisë. Dhe kjo duhet të bëhet në konsultim me partnerët evropianë të NATO-s, përfshirë Ukrainën”, -theksoi Sekretari i Përgjithshëm, Stoltenberg.

NATO i bën thirrje Rusisë të respektojë angazhimet e saj ndërkombëtare

Bullgaria gjithashtu është një aleat tjetër i çmuar i NATO-s në rajonin e Detit të Zi. Sekretari i Përgjithshëm, Stoltenberg, vlerësoi edhe njëherë këtë, kur priti në takim kryeministrin e ri të Bullgarisë, Kiril Petkov të premten e 17 dhjetorit në selinë e NATO-s, që ishte dhe vizita e tij e parë jashtë vendit si kryeministër. Pas urimit për emërimin e tij, Stoltenberg falënderoi Bullgarinë për angazhimin e saj ndaj Aleancës dhe kontributin e saj në sigurinë kolektive të NATO-s në rajonin e Detit të Zi.

“Jam mirënjohës për kontributet e Bullgarisë në sigurinë tonë të përbashkët në rajonin strategjik të Detit të Zi dhe që ju ofroni aftësi të ndryshme, duke përfshirë anije për patrullimet e NATO-s në rajon, gjithashtu mirëpres qasjen tuaj konstruktive për nxitjen e marrëdhënieve të mira në rajon. Bullgaria ndihmon në ndërtimin e stabilitetit në Ballkanin Perëndimor duke kontribuar në misionin paqeruajtës të NATO-s në Kosovë”, u shpreh Stoltenberg dhe informoi më tej mediet se ata kishin diskutuar për vendosjen e konsiderueshme ushtarake të Rusisë në dhe rreth Ukrainës që është e paprovokuar, e pajustificuar dhe që krijon shqetësim të madh te aleatët. “NATO do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e të gjithë aleatëve të NATO-s. Çdo agresion i mëtejshëm kundër Ukrainës do të kishte pasoja masive dhe do të kishte një çmim të lartë. Ne rritëm mbështetjen tonë për integritetin territorial dhe sovranitetin e Ukrainës. Marrëdhëniet e NATO-s me Ukrainën janë çështje vetëm për Ukrainën dhe 30 aleatët e NATO-s”, -vuri edhe njëherë theksin ai. Stoltenberg tha se NATO i ka marrë propozimet e fundit të Rusisë dhe është e qartë se çdo dialog me Rusinë do të duhet gjithashtu të adresojë shqetësimet e NATO-s për veprimet e Rusisë, të bazohet në parimet dhe dokumentet thelbësore të sigurisë evropiane dhe të bëhet në konsultim me partnerët

evropianë të NATO-s si Ukraina. “Por, -tha ai, -aleatët e NATO-s gjithashtu e kanë bërë të qartë se nëse Rusia merr hapa konkretë për të ulur tensionet, ne jemi të përgatitur të punojmë në forcimin e masave të ndërtimit të besimit.”

Ukraina ka të drejtë të mbrohet

I bëjmë thirrje Rusisë që t’i kthehet diplomacisë, për të de-përshkallëzuar dhe për të respektuar sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës”, -tha Sekretari i Përgjithshëm në deklaratën për mediet, që mbajti me presidentin ukrainas Volodymyr Zelenskyy në selinë e NATO-s. “Çdo agresion i mëtejshëm kundër Ukrainës do të ketë pasoja të rënda dhe do të kishte një çmim të lartë”, -tha ai.

“Ne diskutuam për vendosjen e konsiderueshme ushtarake të Rusisë në dhe rreth Ukrainës, me dhjetëra mijëra trupa të gatshme luftarake, tanke, artileri, njësi të blinduara, dronë, sisteme të luftës elektronike. Ne nuk shohim asnjë shenjë se ky grumbullim po ndalet ose po ngadalësohet, përkundrazi, vazhdon. Ky grumbullim nuk ka asnjë justifikim, është provokues, është destabilizues dhe minon sigurinë në Europë. Gjatë viteve të fundit, ne kemi parë një model të veprimeve agresive ruse. Aleatët e NATO-s kanë demonstruar aftësinë për t’u përgjigjur. Që nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia në vitin 2014, ne kemi zbatuar përforsimin më të madh të mbrojtjes sonë kolektive në një brez dhe do të vazhdojmë të bëjmë atë që është e nevojshme për të mbrojtur dhe siguruar të gjithë aleatët e NATO-s. Në të njëjtën kohë, aleatët e NATO-s janë të përgatitur të bisedojnë me Rusinë, ne përsërisim ftesën tonë për Moskën për një takim të Këshillit NATO-Rusi, sepse dialogu është edhe më i rëndësishëm kur tensionet janë të larta”. “Por në të njëjtën kohë, NATO mbetet vigjilente prandaj ajo ka rritur mbledhjen e zbulimit dhe inteligjencës dhe do të vazhdojmë të monitorojmë situatën nga shumë afër. NATO qëndron me Ukrainën, të gjithë aleatët mbështesin sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës dhe nuk e njohin aneksimin e paligjshëm të Krimesë nga Rusia. Si të gjitha shtetet sovraane, Ukraina ka të drejtë të mbrohet, siç parashikohet në Kartën e Kombeve të Bashkuara. NATO do të vazhdojë t’iu japë mbështetje praktike”, -iu tha Stoltenberg medieve. Ndërkohë aleatët po trajtojnë dhe këshillojnë forcat e armatosura të Ukrainës dhe po marrin pjesë në stërvitje të përbashkëta dhe po ofrojnë pajisje. Mbështetja e NATO-s për Ukrainën nuk është një kërcënim për Rusinë. Ukraina ka të drejtë të zgjedhë masat e veta të sigurisë. Ky është një parim themelor i sigurisë evropiane dhe vendimi nëse Ukraina mund të anëtarësohet në NATO do të merret vetëm nga Ukraina dhe 30 aleatët e NATO-s. Ne do të vazhdojmë të qëndrojmë në kontakt të ngushtë në ditët dhe javët në vijim”, -tha Sekretari i Përgjithshëm.



Buxheti civil 289.1 milionë euro, buxheti ushtarak 1.56 miliardë euro

NATO miraton buxhetin e vitit 2022

Në një takim të Këshillit të Atlantikut të Veriut, aleatët ranë dakord për buxhetet civile dhe ushtarake të NATO-s për vitin 2022. Buxheti civil është vendosur në 289.1 milionë euro dhe buxheti ushtarak është caktuar në 1.56 miliardë euro. Të gjitha vendet anëtare kontribuojnë në këto buxhete, sipas një formule të dakorduar për ndarjen e kostos bazuar në të ardhurat kombëtare bruto.

Buxheti civil siguron fonde për personelin civil, kostot operative dhe shpenzimet e programit civil dhe është rritur me 8.9% nga niveli i vitit 2021. Drejtuesi kryesor për këtë rritje të kostos është përshtatja e vazhdueshme kibernetike e NATO-s. Buxheti ushtarak mbulon kostot operative të shtabit

të Strukturës së Komandës së NATO-s dhe programeve, misioneve dhe operacioneve në mbarë botën dhe ka reduktuar 3% nga niveli i vitit 2021.



Përveç buxheteve civile dhe ushtarake, elementi i tretë kryesor i përbashkët i financiar i Aleancës është Programi i Investimeve të Sigurisë së NATO-s (NSIP). Duke mbuluar investimet kryesore të ndërtimit dhe të sistemit të komandës dhe kontrollit, kufiri për 2022 për SKIP është 790 milionë euro.

Nëpërmjet financimit të përbashkët, aleatët e NATO-s demonstrojnë solidaritet dhe bashkohen për të adresuar sfidat e përbashkëta të sigurisë. NATO është e përkushtuar të sigurojë që ne të vazhdojmë të ofrojmë siguri për kombet tona në një mënyrë që të jetë sa efektive dhe e përgjegjshme financiarisht, thuhet në informacionin zyrtar të NATO-s.

Përshëndetja

Faleminderit për gjithçka që bëni, për të mbajtur NATO-n të fortë!

Mesazh urimi i festave fundvitit nga Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg për të gjithë ushtarakët, gratë, trupat dhe veteranët e NATO-s në mbarë botën

Përshëndetje dhe urime të përzemërta për të gjithë burrat dhe gratë e shërbimit tonë!

Ndërsa ky vit po mbyllet, dua të falënderoj të gjithë ata që shërbejnë dhe që kanë shërbyer, nën flamurin e NATO-s, për sakrificat që ju dhe familjet tuaja bëni çdo ditë, për lirinë dhe sigurinë tonë.

Takimi me burrat dhe gratë tona me uniformë është një nga privilegjet më të mëdha të rolit tim. Jam i kënaqur që shumë prej jush i takova sërish personalisht këtë vit, në misionin tonë paqeruajtës në Kosovë, në bordin e HMS Queen Elizabeth, gjatë stërvitjes sonë Stadfast Defender dhe së fundmi, në grupin tonë të betejës shumëkombëshe në kampin Adazi në Letoni. Gjithashtu dua të shfrytëzoj rastin për të falënderuar veteranët tanë, sidomos ata që shërbyen në Afganistan. Për më shumë se njëzet vjet, nuk ka pasur sulme terroriste në vendet tona të organizuara nga Afganistani. Jua kemi borxh këtë dhe unë i falënderoj të gjithë ata që bënë sakrificën përfundimtare për lirinë tonë. Ndërsa presim Vitin e Ri dhe Samitin tonë në Madrid, ne po përshtatim Aleancën tonë, për t'u përballur me një botë më të rrezikshme dhe konkurruese. Ne jemi duke u rritur për të adresuar çdo kërcënim dhe çdo sfidë, në tokë, në det, në ajër, në hapësirë dhe në hapësirën kibernetike. Kjo fillon me forca të armatosura të forta dhe të afta. Kjo fillon me ju!

Ju përfaqësoni frymën dhe forcën e Aleancës sonë. Të gjithë për një dhe një për të gjithë.

Ju uroj ju dhe familjet tuaja gjithë të mirat për festat e fundvitit.

Faleminderit për gjithçka që bëni, për të mbajtur NATO-n të fortë dhe për të na mbajtur të gjithëve të sigurt.



Vjelja e mjaltit të NATO-s 2021

Që nga prilli 2020, selia e NATO-s në Bruksel ka qenë shtëpia e tre koshere bletësh. Në vitin 2020 është prodhuar 25 kg mjaltë natyral. Edhe pse viti 2021 ishte një vit i vështirë për prodhimin e mjaltit në Belgjikë, ai doli të ishte një vit çuditërisht produktiv për bletët e NATO-s. Rreth 60 kilogramë mjaltë me cilësi të lartë u morrën në lokacionin e shtabit të NATO-s, i cili u vlerësua si "Vendi më i mirë për prodhim" nga bletari, Made in Abeilles.

Pjesa më e madhe e prodhimit, 350 kavanoza, u shit në Pazarin e Bamirësisë së NATO-s në nëntor. Të ardhurat nga shitja e mjaltit iu shtuan fondit të përgjithshëm të mbledhur në Pazar këtë vit, nga të cilat do të përfitojnë 34 projekte belge dhe ndërkombëtare të miratuara për financim në 2021.

Duke ndjekur traditën e vitit të kaluar, Sekretari i Përgjithshëm u dha ambasadorëve në Këshillin e Atlantikut të Veriut nga një kavanoz me mjaltë të NATO-s secili më 15 dhjetor 2021. Aramark, ofruesi i shërbimit të ushqimit të NATO-s, bleu gjithashtu kavanoza për të përdorur mjaltin si një përbërës për pjatat në kafenenë e NATO-s. Mirëqenia e bletëve është e lidhur ngushtë me qëndrueshmërinë dhe mbrojtjen e habitateve dhe ekosistemeve tona natyrore. Në gusht, në selinë e NATO-s u organizua një seminar për vjeljen e mjaltit. Më shumë seminare dhe sesione informuese do të pasojnë për t'i lejuar njerëzit të mësojnë më shumë për bletët dhe kontributin e tyre në të ardhmen e qëndrueshme.



Parandalimi dhe Mbrojtja aleate

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s vlerëson kontributin e Francës

Admirali Rob Bauer, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s ishte në Paris, (17 dhjetor 2021) për t'u takuar me generalin Thierry Burkhard, Shef i Mbrojtjes i Forcave të Armatosura Franceze. Ai gjithashtu vizitoi Qendrën për Planifikimin dhe Kryerjen e Operacioneve ku mori një sërë informimesh mbi aktivitetet ushtarake të Francës.

Pas pritjes zyrtare në "École Militaire" në Paris, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Bauer vizitoi Qendrën për Planifikimin dhe Kryerjen e Operacioneve. Që nga viti 2004, kjo njësi kryesore ka mbështetur aftësinë e Francës për të planifikuar dhe kryer operacione ushtarake kombëtare dhe ndërkombëtare që përfshijnë trupat e saj. Në komunikim të vazhdueshëm me komandat operacionale në mbarë botën, duke përfshirë misionet e vendosura, qendra mundëson koordinim më të mirë, përgjigje më të shpejta ndaj situatave në zhvillim dhe menaxhim të përmirësuar të krizave. Admirali gjithashtu u informua mbi prioritetet 360° të Francës dhe aktivitetet e vazhdueshme ushtarake, përfshirë operacionet e saj aktuale në Mali dhe Irak, si dhe pjesëmarrjen e saj të vazhdueshme në misionet e BE-së dhe NATO-s. Aktualisht, Franca po kontribuon në Misionin e Përmirësuar të Policisë Ajrore të NATO-s dhe në Grupin e Betejave Shumëkombëshe në Estoni si pjesë e Prezencës së Përparuar të Përmirësuar të NATO-s. "Aktualisht janë 30 000 trupa franceze të dislokuara brenda dhe jashtë vendit për të mbrojtur vendin, njerëzit dhe vlerat. Një pjesë e këtyre trupave është vendosur për të mbështetur misionet e BE-së dhe NATO-s që mundëson sigurinë, parandalimin dhe mbrojtjen e territorit euroatlantik", -shtoi ai.

Admirali Bauer falënderoi Francën edhe për ofertën për të pritur Qendrën e re të NATO-s të Ekselencës për Hapësirën, e cila do të krijohet në Toulouse deri në vitin 2025. "Franca po kontribuon në mënyrë aktive në fushat tradicionale për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Aleancës, dhe tani kjo do të përfshijë edhe Hapësirën", -përfundoi ai.

Shefat e Mbrojtjes Ushtarake të NATO-s, thërrasin takimin e parë për vitin 2022

Autoriteti më i lartë Ushtarak i NATO-s, Komiteti Ushtarak, do të takohet më 12-13 janar 2022, në Bruksel, Belgjikë. Admirali Rob Bauer, Kryetari i Komitetit Ushtarak, do të kryesojë seancat, në të cilat do të marrin pjesë shefat e mbrojtjes aleate. Ata do të mbështeten nga gjenerali Tod Wolters (Komandanti Suprem i Aleatëve në Europë, SACEUR) dhe gjenerali Philippe Lavigne (Komandanti Suprem i Aleatëve për Transformim, SACT).

Sesioni i Komitetit Ushtarak të Shefave të Mbrojtjes të NATO-s (MCCS) u mundëson shefave të mbrojtjes të takohen dhe të diskutojnë çështje me rëndësi strategjike për Aleancën. Shefat e Aleatëve do të takohen me partnerët e tyre operacionale për të diskutuar misionin e udhëhequr nga NATO në Irak dhe misionin e Forcave të Kosovës. Komiteti Ushtarak do të takohet gjithashtu, për herë të fundit në këtë format, me ish-Partnerët e tyre të Mbështetjes Vendimtare për të diskutuar mësimet e nxjerra/mësimet e identifikuar nga Afganistani. Shefat e Mbrojtjes së Aleatëve do të kenë më pas takimin e tyre vjetor me homologët e tyre gjeorgjian dhe ukrainas, përkatësisht, për të diskutuar situatën e sigurisë në vendet e tyre, si dhe përparimin e vazhdueshëm me reformat në lidhje me mbrojtjen. Komiteti Ushtarak takohet në Sesionin e Shefave të Mbrojtjes dy herë në vit në selinë e NATO-s në Bruksel dhe një herë në vit në një shtet anëtar aleat.



“Europa e re” nën “kërcënimin e vjetër”



Kolonel HYSNI GJERGJI
Instituti Kërkimor Shkencor
Ushtarak (IKSHU)

Analistët e gjeopolitikës gjatë ditëve të fundit, po paralajmërojnë për një rritje dhe përshkallëzim të tensionit ndëretnik në Ballkanin Perëndimor, duke hapur plagët e pashëruara të së shkuarës së afërt. Shumica e studiuesve e paraqesin përshkallëzimin e Kërkesave të Republikës Sërbska në BiH; Lëvizjet nacionaliste anti-perëndimore në RMV; Përplasjet dhe tensionet për arsye të kishës serbe në Mal të zi; peng mbajtja e refugjatëve në kufirin Bjellorusi-Poloni; si dhe demonstrimet serbe në kufi të Kosovës me pretekstin e reciprocitetit të targave; si veprime të sponsorizuara, analizuara, të mbështetura dhe në interes të Moskës. Inteligjenca perëndimore e vlerëson një “probabilitet të lartë të destabilizimit” të Ukrainës nga Rusia këtë dimër, pasi Moskë ka grumbulluar më shumë se 90,000 trupa në kufirin e saj, sipas zëvendësministrit të Mbrojtjes, Hanna Maliar. Kur u pyet nëse rreziku i agresionit ushtarak rus ishte më i lartë se në vitet e fundit, ajo u përgjigj: Informacionet nga shërbimet tona të inteligjencës ushtarake përpunohen me informacionin nga vendet partnere mbi probabilitetin e lartë të destabilizimit të situatës në Ukrainë këtë dimër që po afron. Lëvizja e fundit e trupave dhe tankeve ruse drejt Ukrainës e nxiti drejtorin e CIA-s Bill Burns të vizitonte Moskën këtë muaj, ku foli me telefon me Putinin. Angela Merkel, bashkëbiseduesja kryesore e Putinit në Evropë, i kërkoi gjithashtu të mërkurën që të përdorte ndikimin e tij me aleatin e Rusisë, Bjellorusinë për të zbutur krizën mbi mijëra emigrantë nga Lindja e Mesme që kërkojnë të kalojnë kufirin me Poloninë për në BE.

Zemra dhe shpirti i inteligjencës ruse, është subversioni i cili synon në marrjen e masave aktive për të dobësuar perëndimin, të fusë përçarje të të gjitha llojeve në mes të komunitetit ndërkombëtar dhe aleancës së NATO-s, të mbjellë mosmarrëveshje mes tyre për të dobësuar dhe bërë të pabesueshme SHBA-në dhe NATO-n në sytë e publikut, thotë Oleg Kalugin, ish drejtues i lartë i KGB-së.

Rusia aktualisht nuk ka prezencë me trupa ushtarake në “Europën e Re”, siç i emërton ajo shtetet e ish Traktatit të Varshavës, ku bën pjesë edhe Ballkani Perëndimor. Megjithatë Moskë ka zhvilluar dhe vazhdon të zhvillojë një “luftë hibride” kundër ndikimit të perëndimit në rajon, me mjete dhe armë të tjera. Këto “armë të vjetra” kanë qenë përdorur që në luftën e ftohtë siç janë; propaganda, spiunazhi, subversioni, sabotazhi, ndihma për grupet nacionaliste pro ruse, e



deri tek vrasjet e vlerësuara me interes për zbulimin rus. Përveç këtyre armëve “tradicionale”, Moskë po përdor edhe mjetet e reja që teknologjia ofron; si interneti me rrjetet sociale, kiberkrimi etj.

Kombinimi i këtyre armëve dhe mjeteve përbën armën hibride e cila definohet e propozuar për herë të parë nga Frank Hoffman: Lufta hibride është strategji e teorisë ushtarake, e cila ndërthur luftën politike, luftën konvencionale, luftën asimetrike, luftën kibernetike si dhe metodat e tjera influencuese të tilla si lajmet e rreme, diplomacinë, ligjin dhe ndërhyrjen e huaj në zgjedhje”. Siç definohet nga NATO, “kërcënimet hibride kombinojnë mjetet ushtarake dhe jo-ushtarake, sekrete dhe të hapura, duke përfshirë dezinformimin, sulmet kibernetike, presionin ekonomik, vendosjen në terren të grupeve të armatosura paramilitare dhe përdorimin e forcave të rregullta ushtarake. Metodot hibride përdoren për të mjegulluar kufijtë midis luftës dhe paqes, si dhe në përpjekjen për të mbjellë dyshime në mendjet e popullatave të synuara si grupe interesi strategjik”. Strukturat “hibride ruse” ia kanë arritur të jenë të shtrirë si në shtetet e trazuara të Ballkanit Perëndimor dhe “Europës së Re” ashtu edhe në shtetet e pasura të “Europës së Vjetër” madje edhe në vetë komandën e NATO-s në Bruksel. Duke analizuar të dhënat e publikuara deri në nëntor 2021, numri i vendeve të shënjestruara nga Moskë ka qenë i madh. Pothuaj çdo vend ka pasur histori të hidhura me ndërhyrjen ruse, duke filluar qysh nga shtabi i NATO-s në Bruksel; “Mund të konfirmojmë se kemi tërhequr akreditimin e tetë anëtarëve të misionit rus në NATO, të cilët ishin punonjës të padeklaruar të inteligjencës ruse”, -deklarohet zyrtarisht më 1 tetor

2021 nga zëdhënësi i NATO-s.

Operacionet subversive, terroriste dhe sabotuese ruse kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë qëllim; të krijojnë një klimë pasigurie, mosbesimi dhe të ndryshojnë e manipulojnë perceptimin e publikut për realitetin perëndimor, me ideologji, politika dhe liderë në favor të modelit Rus. Subversioni ideologjik, është model i vjetër dhe një proces i gjatë e i ngadaltë, që Moskë vazhdon të kryejë në të gjithë vendet ish komuniste qysh në epokën e luftës së ftohtë. Këto operacione, sipas Juri Bezmenov ish officer i lartë i KGB-së, zakonisht ekzekutohen me katër faza; a- “Demoralizimi” i shoqërisë në

shtetin e zgjedhur për këtë operacion. Në literaturën e shërbimeve ruse të inteligjencës “demoralizimi” zgjat deri në 20 vjet, që është edhe koha e mjaftueshme për të arsimuar një gjeneratë. Në këtë fazë synohet edhe ndihma e medias, publicistëve dhe analistëve të cilët janë simpatizantë pro rusë. Fjalimet bashkë me publikimet, intervistat televizive të sponsorizuara në favor të tyre kanë rezultuar shumë efikase, madje edhe në SHBA.

b- “Destabilizimi” është faza e dytë, por që është vazhdim i fazës së parë, dhe që zgjat nga 2 deri në 5 vjet. Në këtë periudhë gjendet dhe bëhen përgatitjet

rreth objektivit. “Shënjestër” zgjidhet elementi ose instrumenti i sigurisë kombëtare të vendit “shtet interesi” që vlerësohet të ketë më shumë impakt. Zakonisht janë zgjedhur; ekonomia, politika brendshme, diplomacia, siguria e brendshme, stabiliteti social, zgjedhja e lidershit të ri, FA-të apo edhe një element tjetër vlerësuar nga zbulimi rus. Qëllimi më i lartë i destabilizimit është arritja e marrjes së mbështetjes së brendshme të publikut të shtetit shënjestër. Në këtë fazë synohet publiku tashmë i “demoralizuar” dhe i “destabilizuar”, që të kërkojë kthim në modele autoritare dhe nostalgji ndaj traktatit të Varshavës dhe epokës sovjetike. Në këtë fazë është përzgjedhur dhe hedhur në veprim edhe “lidhshipi” i ri, si shpëtimtar nga gjendja e krijuar. Shembujt e liderëve pro rusë nuk kanë munguar, po shfaqen dhe po shtohen në Europën lindore dhe Ballkanin Perëndimor qoftë si individë dhe qoftë si parti pro ruse.

c - Kriza është “faza e tretë” e cila mund të zgjasë deri në dy muaj, ku do të mbizotërojë kaosi, dhuna, pasiguria e jetës, protestat ndaj qeverive vendase etj. Në varësi të ecurisë së fazave të tjera, në këtë stad kërkohet që të pranohet deri në një masë të caktuar “ndihma ruse” ose nostalgjia për modelin sovjetik të ndërtimit të shtetit; premisë e krijuar në kufirin bjellorus – polak është shumë domethënëse pasi Rusia në fillim e mbështet qëndrimin e Lukashenkos ndërsa më datën 14 nëntor 2021, deklarohet kritik edhe jep mesazhin e shpëtimtarit. Po kështu ka vepruar pas trazirave në Mal të zi dhe në kufirin Serbi-Kosovë.

d- Normalizimi është “faza e zgjidhjes”, vlerësimi i së cilës do të varet nga



“status quo” që kërkohet të arrihet, duke përfshirë ose jo ndërhyrjen ushtarake si zgjidhje. Ndërhyrja në Ceki në 1968, në Ukrainë dhe në Krimë është bërë afërsisht sipas këtij skaneri. Sipas analizës së Jounus Bugajski kjo parashikohet të arrihet edhe me Bjellorusinë në të ardhmen e afërt. Krijimi i krizave dhe pastaj ofrimi i ndihmës është një skenar që pritët të vihet në veprim në të gjitha republikat ish sovjetike.

Kanë ndodhur një varg skandalesh spiunazhi, subversioni dhe sabotazhi në “Europën e re” dhe Ballkan të raportuara nga media, që përfshijnë qytetarë dhe zyrtarë rusë, duke filluar nga viti 1995 deri në 2021. Nuk është më sekret dhe tashmë po shfaqet qartë në shumë media, që rajoni ka qenë prej kohësh një skenë e rëndësishme aktiviteti për shërbimet inteligjente të Kremlinit. Rusia ka shkuar shumë larg në taktikat e saj subversive, sabotuese dhe përcarëse, me anë të zbulimit ushtarak, duke synuar dhe penguar përpjekjet e vendeve të Ballkanit dhe “Europës së re” për anëtarësim në NATO dhe BE. Shtetet perëndimore në mënyrë të përsëritur kanë inkurajuar përpjekjet e vendeve të rajonit tonë, për t’i rezistuar infiltrimit rus, që ka çuar në ndjekje, vëzhgim, zbulim dhe denoncim të veprimtarisë së tyre.

Presidenti Putin, që ishte edhe vetë një ish oficer zbulimi, njihet për hobin e tij ndaj operacioneve të inteligjencës. Ai i ka akorduar fonde në rritje tek tre shërbimet ruse të spiunazhit: Shërbimi i Jashtëm i Inteligjencës (Sluzhba Vneshney Razvedki), SVR; Shërbimi i Sigurisë Federale (Federalnaya Sluzhba Bezopasnosti), FSB dhe Shërbimi i Inteligjencës Ushtarake, GRU (Glavnoye Razvedyvatelnoye Upravleniye). Agjentët rusë në Europë jetojnë dhe veprojnë kryesisht “pa rënë në sy” në periferi të qyteteve perëndimore. Ata mësojnë shumë mirë gjuhën e shtetit ku do të operojnë, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë dhe lehtësitë që ofrojnë dhe garantojnë shoqëritë e hapura demokratike.

Disa nga rastet e raportuara në media janë: Më 16 tetor 2020 ndodhi shpërthimi masiv në një depo municionesh në qytetin Vrbetice, të Cekisë duke vrarë dy njerëz dhe duke shkaktuar dëme të mëdha materiale. Një shpërthim tjetër ndodhi në dhjetor të 2014 me dëme të konsiderueshme materiale. Praga depërtoi 18 agjentë të GRU-së, të cilët kishin pasaporta diplomatike dhe pjesë e stafit diplomatik në Ambasadën ruse në Pragë të dyshuar për këto sulme. Në mediat botërore ka filluar të shkruhet për njësinë speciale të GRU-së, “29155” e cila bën kryerjen e operacioneve të fshehta jashtë Rusisë, sulme që janë në mes të spiunazhit, sabotazhit si dhe vrasjen e personave me interes për GRU-në. Agjentet e “Njësisë 29155” udhëtojnë me identitete të rreme dhe pasaportat e tyre ndërrohen çdo dy vite. Pasaportat kanë numra serialë të rezervuar vetëm për agjentët e zbulimit ushtarak rus GRU.

Megjithëse shfrytëzojnë identitete të rreme, shërbimet inteligjente perëndimore kanë arritur që të identifikojnë disa nga agjentet e GRU-së të cilët ishin të implikuar në: Sulmin ndaj Emilian Gebrev në Bullgari; Sulmin ndaj Sergei Skripal në Britaninë e Madhe; Shpërthimin e depove të municionit në Ceki; Tentimin për grusht shteti në Malin e Zi etj. Në

atentatet ndaj biznesmenit bullgar Emilian Gebrev, me 15 shkurt dhe 28 maj 2015, është përdorur agjenti helmues ushtarak Novichok. Në vitin 2018, edhe vendi ynë dëboi dy diplomatë rusë, duke provuar se aktivitetet e tyre nuk ishin në përputhje me statusin e tyre diplomatik. Shqipëria u bashkua me Mbretërinë e Bashkuar, BE, SHBA-në, dhe Kanadanë në një përgjigje të koordinuar ndaj helmimit me agjent nervor të Sergei Skripal, një ish-zyrtar i inteligjencës ruse dhe vajzës së tij, Julia, në Salisbury Angli. Në janar të 2021, përsëri vendi ynë dëboi një diplomat rus për shkelje të rregullave që synojnë ndalimin e përhapjes së koronavirusit. Qeveria shqiptare e shpalli Aleksei Krivosheev “persona non grata” dhe i kërkoi atij të largohej nga vendi brenda 72 orësh, për shkak të shkeljeve “të përsëritura” të kufizimeve të pandemisë nga diplomati rus që nga prilli i vitit 2020. Besohet se ky nuk është fillimi, apo i vetmi aktivitetit rus kundër interesave dhe ambicieve euro-atlantike të vendit tonë. Shqipëria priste të kurorëzonte arritjen më të madhe historike në 2008, që ishin pavarësia

Sipas asaj që ka njoftuar Ministria e Punëve të Jashtme, “sjellja e diplomatit nuk ishte në përputhje me sjelljen e pritur nga Maqedonia”. “Ministria e Punëve të Jashtme njoftoi se në bazë të nenit 9 të Konventës së Vjenës për marrëdhënie diplomatike, vendosi të shpallë një diplomat të ambasadës së Federatës Ruse si “persona non grata” në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Rumania njoftoi gjithashtu se do të deklaronte një diplomat rus “persona non grata”. Marrëdhëniet diplomatike të Rumanisë me Rusinë kanë qenë të tensionuara, veçanërisht që nga koha kur Rusia aneksoi Krimenë në vitin 2014. Sllovakia: Në raportin vjetor të SIS për sigurinë, thuhet se “aktivitetet e shërbimeve sekrete ruse në Sllovakia janë të fokusuar në sigurimin e informatorëve në organet e administratës shtetërore, në fushën e energjetikës dhe në forcat e sigurisë dhe mbrojtjes”. Mali i Zi dhe Rusia janë në marrëdhënie të tensionuara, pas një komploti të mbështetur nga Rusia për të vrarë kryeministrin e Malit të Zi, për të përmbytur qeverinë dhe për të

me akuzën “Subversion dhe sabotim të integritetit dhe të sigurisë kombëtare të Greqisë”. Qeveria greke akuzoi zyrtarët rusë se po zhvillonin spiunazh, për të marrë dhe shpërndarë informacione sensitive lidhur me sigurinë kombëtare. Bullgaria, ka qenë aleati më i besueshëm politik i Moskës në Evropën Lindore gjatë kohës sovjetike dhe më vonë. Në rastin Skripal për hir të kësaj miqësie, Sofja në fillim nuk ishte dakord me vendet e Perëndimit. Në tetor 2019, udhëheqësi i lëvizjes bullgare “Russophiles” (“Rusofili”), Nikolay Malinov, arrestohet me akuzën e “spiunazhit në favor të Rusisë”. Në shtator 2020, Sofja përballët përsëri me spiunazhin rus, dhe dëboi dy diplomatë rusë të akredituar në vendi “persona non grata”. Ata akuzohen se ishin “duke mbledhur informacione sekrete shtetërore në lidhje me Bullgarinë për t’ia dorëzuar ato një vendi tjetër”. Një diplomat tjetër rus, që shërbente në zyrën e bashkëpunimit tregtar të Rusisë në Sofje, kishte mbledhur informacione konfidenciale mbi sigurinë e energjisë që nga tetori 2018. Një grua, shihet në

e eksplodimeve në fabrikën e municioneve “Sloboda”. Shpërthimi i fundit ka ndodhur dy ditë më parë, të dyshuara si të kryera nga rusët, të cilët kanë për qëllim të mbajnë Vuçiçin në linjë dhe ta pengojnë atë të afrohet më shumë me BE-në sipas teorisë së “shkopit dhe karotës”. Presidenti Vuçiç pranoi vërtetësinë e videos së zbuluar, duke iu drejtuar Rusisë, vetëm me një fjalë që mbart shumë zhgënjim, “Pse?”

Më 24 tetor 2021, Kosova shpall “non grata” 2 diplomatë rusë që akuzohen për spiunazh, shkelje të sigurisë kombëtare dhe tejkalim të statusit të tyre diplomatik. Siç shikohet nga shembujt e mësipërm, asnjë vend i “Europës së re” madje edhe asaj perëndimore nuk ka mbetur jashtë “kërcënimeve të vjetra” ruse. Gjykatat ndërkombëtare po ndërjegjësohen për këtë rrezik në rritje dhe me datë 21 shtator 2021 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka nxjerrë një vendim, ku nënvizohet se Rusia është përgjegjëse për vrasjen e ish-oficerit të sigurisë Aleksandar Litvinenko

Here are the locations and times of the explosions in Bulgaria.




e Kosovës dhe anëtarësimi në NATO, në kohën kur ndodhën shpërthimet e fabrikave të demontimit të municionit, duke shkaktuar shumë viktima dhe dëme materiale, deri tani pa autor. Kroacia dhe vendet e tjera të rajonit të Ballkanit, gjithashtu u solidarizuan kundër Rusisë. Kryeministri kroat Andrej Plenković tha në atë kohë se Zagrebi kishte vendosur të tregonte “solidaritet me Mbretërinë e Bashkuar” dhe të shpallte të padëshiruar një diplomat Rus të akuzuar për spiunazh. Një diplomat rus është shpallur “persona non grata” dhe ai duhet të largohet nga Maqedonia e Veriut për disa orë, raportojnë mediat maqedonase. Sipas mediave, më 14 maj 2021, ambasadori rus Sergei Bazdikin u thirr në Ministrinë e Punëve të Jashtme për t’u informuar se një nga diplomatët në ambasadën e tij ishte shpallur person i padëshirueshëm.

parandaluar anëtarësimin e republikës ish-Jugosllave në NATO. Në tetor 2016, autoritetet malazeze zbuluan një komplot të kurdisur nga ultra-nationalistët serbë dhe oficerë të sigurisë ruse, për të përmbytur qeverinë e presidentit Gjukanovic. Gjykata e Lartë në Malin e Zi, dy agjentet rusë i ka dënuar në mungesë, Eduard Shishmakovin me 15 vite burgim, ndërsa Vladimir Popov me 12 vite burgim. Serbia, Greqia dhe Bullgaria në fillim nuk dëbuan diplomatë rusë, dhe nuk vepruan që në fillim si shtetet e tjera në mbështetje dhe solidarizim me Britaninë për rastin Skripal. Kjo nuk zgjati, shumë, pasi shumë shpejt ata vërtetuan se “miqtë rusë” nuk i kishin kursyer edhe ata vetë, në aktivitetet e spiunazhit dhe subversionit. Greqia, në qershor të vitit 2018 urdhëroi dëbimin e dy diplomatëve rusë dhe ndaloi hyrjen e dy të tjerëve

një video duke biseduar me dikë, ndërsa brenda godinës, kamera e sigurisë kap një burrë duke numëruar paratë në tryezën e punës, që mendohet se ishin shpërblimi për spiunazhin. Prokurorët njoftuan se 6 shtetas bullgarë akuzohen për spiunazh për Rusinë duke deklaruar se grupi “përbën një kërcënim serioz për sigurinë kombëtare, pasi mbledh dhe dorëzon tek Rusia sekretet e Bullgarisë, NATO-s dhe Bashkimit Evropian”. Serbia në nëntor të vitit 2019, pa prituri përball me Moskën, pavarësisht nga lidhjet historike “vëllazërore” midis dy vendeve. Të dy oficerët shihen qartë në video duke shkëmbyer çanta dhe duke numëruar paratë. Oficeri rus u identifikua si Georgiy Kleban, zëvendës atashe ushtarak në ambasadën ruse në Beograd. Në qershor 2021 në Çaçak të Serbisë ka ndodhur një seri

në Londër. Litvinenko ndërroi jetë në vitin 2006 pasi kishte pirë çaj të helmuar me Polonium-210, një izotop i rrallë radioaktiv. Këto janë raste të denoncuar në media dhe sigurisht nuk janë gjithçka. Logjika profesionale të çon në përfundimin se shumë të tjera nuk janë zbuluar ende dhe vazhdojnë të ndodhin edhe në këto momente që ne po analizojmë. Problemi më i madh në botën e inteligjencës nuk është çfarë shfaqet, por “çfarë nuk dihet akoma”. Operativët e inteligjencës ruse besohet se janë pranë nesh duke u përgatitur të sabotojnë, të terrorizojnë dhe të kryejnë aksione sipas prioritetëve të Moskës. Raporti teorik i pranuar i agjentëve të zbuluar, me ata që nuk zbulohen, historikisht besohet të jetë afërsisht 1 me 100, çfarë na bën të mendojmë se sa shumë të tjerë janë në veprim pikërisht tani.



Ministri Mehaj dhe zëvendësministri Sylja së bashku me gjeneralin Kudusi Lame diskutuan për mjedisin e sigurisë në rajon dhe më gjerë si dhe zhvillimet aktuale gjeopolitike globale. Ata u pajtuan se orientimi euroatlantik i Shqipërisë dhe Kosovës është përcaktimi ynë i natyrshëm dhe se zhvillimi i kapaciteteve të mbrojtjes së dy vendeve mbi konceptin e mbrojtjes së SHBA-së dhe NATO-s është realitet i fuqishëm të cilin duhet ta ruajmë dhe forcojmë në vazhdimësi.



Vizita

Mehaj: Zhvillimi i kapaciteteve të mbrojtjes së dy vendeve, realitet i fuqishëm të cilin duhet ta ruajmë dhe forcojmë në vazhdimësi

Ministri Mehaj priti në vizitë gjeneralin Kudusi Lame. Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, i shoqëruar nga zëvendësministri Shemsi Sylja, priti në takim ish-komandantin e Divizionit të Kukësit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneral Kudusi Lame.

Me këtë rast, ministri Mehaj i shprehu mirënjohje gjeneral Lames për kontributin e madh të tij dhe gjithë ushtarakëve të FARSH, të angazhuar gjatë luftës për çlirimin e Kosovës.

Në vazhdim, ministri Mehaj dhe zëvendësministri Sylja së bashku me gjeneral Lame diskutuan për mjedisin e sigurisë në rajon dhe më gjerë si dhe zhvillimet aktuale gjeopolitike globale.

Ata u pajtuan se orientimi euroatlantik i Shqipërisë dhe Kosovës është përcaktimi ynë i natyrshëm dhe se zhvillimi i kapaciteteve të mbrojtjes së dy vendeve mbi konceptin e mbrojtjes së SHBA-së dhe NATO-s është realitet i fuqishëm të cilin duhet ta ruajmë dhe forcojmë në vazhdimësi.



Bota e xhudos po "sundohet" nga vajzat dardane.

Pas përditësimit të renditjes Botërore në këtë sport, Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova janë në vendin e parë në kategoritë përkatëse.

Këtë lajm e ka bërë të ditur "Kosovo Judo Federation".

Distria Krasniqi është në vendin e parë në botë, në kategorinë 48 kilogramë, me gjithsej 5920 pikë.

Kurse, Nora Gjakova ka gjithsej 5880 pikë dhe është e para në kategorinë 57 kilogramë. Ky është edhe një sukses i madh për kampionet olimpike.

Ditë më parë, Distria ishte zgjedhur xhudistja më e mirë në botë nga Komiteti Olimpik i Xhudos pas votimit online.


Ndërsa, Driton Kuka u zgjodh trajneri më i mirë në glob.

Krasniqi ishte e jashtëzakonshme në Lojërat Olimpikë të mbajtura në Tokio.

25-vjeçarja është medalistja e dytë e artë olimpike e Kosovës, pas Majlinda Kelmendit, e cila ishte shpallur kampione në "Rio 2016". Distria kishte mposhtur në finale xhudisten japoneze, Funa Tonakin. Ndërsa, Gjakova kishte mposhtur në gjysmëfinale japonezen, Tskukasa Yoshida, e cila ishte dhe pretendentja kryesore në peshën deri në 57 kg. Ndërsa, në finale e kishte "gjunjzuar" xhudisten franceze, Sarah Leonie Cysique.

Vajzat dardane po e "sundojnë" botën





Armata është e rëndësishme jo vetëm për anëtarësimin në NATO, por edhe për anëtarësimin në BE. “Armata dhe Mbrojtja janë të rëndësishme jo vetëm për anëtarësimin tonë në NATO, por edhe për anëtarësimin në BE, që është edhe prioriteti ynë strategjik. Qeveria dje konfirmoi se Maqedonia e Veriut do t’i bashkohet grupit luftarak shumëkombësh të BE-së me seli në Greqi, HELBROC, i cili është pjesë e politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes të Unionit dhe në të cilin do të kontribuojmë me një tog të lehtë të këmbësorisë.



Ministrja Shekerinska në pranimin e 100 ushtarëve të rinj profesional

Shekerinska: Armata dhe Mbrojtja nuk janë të rëndësishëm vetëm për anëtarësimin tonë në NATO, por edhe për anëtarësimin në BE

Ministrja Radmilla Shekerinska mori pjesë në ceremoninë e pranimit të 100 ushtarëve të rinj profesional, që u mbajt në kazermën “ASleksa Demnievski – Bauman”, në Veles. Në konkurs u paraqitën 895 kandidatë, me çka sërish u konfirmua interesi i shtuar që në katër vitet e fundit vazhdimisht rritet për shkak të kushteve të punës të përmirësuara.

Duke i uruar për pranimin e tyre, ministrja tha se janë njëqind ushtarët e parë që hyjnë në Armatë pas integritit të plotë ushtarak në NATO. “Për ju është nder dhe për ne përgjegjësi të bëjmë gjithçka që është e nevojshme për të dhënë maksimumin tuaj. Sot me krenari mund të themi se çdo pjesëtar i Armatës ka dy komplete uniformash luftarake, çizme, pajisje sportive, se kemi siguruar pajisje alpinistike, pajisje MABK dhe se kemi hyrë në procesin e modernizimit të Armatës me mjete të reja të blinduara dhe armatime të reja moderne,” -tha Shekerinska.

Ministrja tha se Armata është e rëndësishme jo vetëm për anëtarësimin në NATO, por edhe për anëtarësimin në BE. “Armata dhe Mbrojtja janë të rëndësishme jo vetëm për anëtarësimin tonë në NATO, por edhe për anëtarësimin në BE, që është edhe prioriteti ynë strategjik. Qeveria dje konfirmoi se Maqedonia e Veriut do t’i bashkohet grupit luftarak shumëkombësh të BE-së me seli në Greqi, HELBROC, i cili është pjesë e politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes të Unionit dhe në të cilin do të kontribuojmë me një tog të lehtë të këmbësorisë. Me këtë ne tregojmë se ambicet tona nuk përfunduan me anëtarësimin në NATO, por u shtuan dhe do të jemi një argument plus për anëtarësimin tonë në BE”, -nënvizoi ministrja. Ministrja theksoi gjithashtu se anëtarësimi në NATO ka rritur përparësitë për Armatën.

“Na u hapën dyert për një potencial të madh përmirësimi në shërbim, i cili jam e bindur se do të shfrytëzohet nga të gjithë pjesëtarët e Armatës. Do të keni mundësinë të merrni pjesë në shumë trajnime të NATO-s, të jeni pjesë e misionëve të ndryshme të NATO-s dhe të tregoni të njëjtat aftësi dhe të njëjtat njohuri si ushtritë aleate”, -tha Shekerinska.



Nga viti i ardhshëm ushqim falas për pjesëtarët e Armatës, paralajmëruan ministrja Shekerinska dhe gjenerali Gjurçinovski

Nga viti 2022, pjesëtarët e Armatës, në radhë të parë ata që janë pjesë e Grupit të Lehtë Luftarakë të Këmbësorisë në Shtip, dhe nga viti 2023 e tërë Armatë, do të marrin ushqime të siguruar, falas gjatë gjithë vitit përmes një kompanie të jashtme për të cilën aktualisht është shpallur tenderi për prokurim publik.

Ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska, tha se Armata është institucion me respektin më të madh në mesin e qytetarëve dhe se në vitet e fundit vendi ka filluar të vlerësojë vërtetë vendin e tij në shoqëri, veçanërisht me futjen e standardeve të NATO-s në Armatë.

„Filluam me rritje serioze të të ardhurave të pjesëtarëve, fillimisht me rritjen e pagave, pastaj me shtimin e shtesave, rritjen e shtesave në shërbime të caktuara, sigurimin e mëditjeve të papaguara me vite. Kemi nisur një projekt me të cilin po shkojmë dhe një hap më tej. Pjesëtarët e Armatës me të vërtetë meritojnë të hanë një vakt falas që do të financohet nga buxheti dhe për këtë arsye dy ditë më parë u shpall tenderi i parë i cili do të sigurojë ushqim falas për të gjithë pjesëtarët e grupit tonë luftarak të këmbësorisë së lehtë që të cilët janë me vendndodhje në Shtip”, tha ministrja

„Synimi është që në përputhje me planin tonë shumëvjeçar financiar për vitin ’22 të sigurojmë mbulim të plotë të kësaj diete të organizuar në Shtip, dhe tashmë nga viti 2023 kemi planifikuar fondet për ushqim praktikisht falas për çdo pjesëtar të ushtrisë pa marrë parasysh se ku ndodhet, tha ministrja.

Ministri tha se ky do të jetë një shans i madh që kompanitë vendase të tregojnë kapacitetet e tyre „Ky do të jetë një shans për kompanitë vendore që do të kenë mundësi të ofrojnë plotësisht ushqimin për ushtrinë, përkatësisht Ministrinë e Mbrojtjes që do të jetë 365 ditë në vit, dhe do të jetë një shans për të marrë pjesë në tenderë vendor, maqedonas, por edhe për në disa nga tenderat e NATO-s që mund të shfaqen në rajonin tonë”, tha ministrja. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral Vasko Gjurçinovski tha se për faktin se Armata është institucion me vlerësim më të lartë, është e nevojshme të qëndrojmë në rrugën e zhvillimit dhe

përmirësimi të statusit jetësor dhe standardit të çdo pjesëtarit të Armatës.

„Në mbështetje të institucioneve tona shtetërore, ne i kemi përballuar me sukses zjarret që patëm këtë verë. Prej disa vitesh jemi angazhuar në mbështetjen e institucioneve dhe ministrive qeveritare në përballjen me krizën COVID, si dhe krizën e emigrantëve. Do të vazhdojmë edhe në periudhën e ardhshme. Konceptin final të integritit ushtarak në NATO e kemi zbatuar me sukses, shpejt dhe me efikasitet, sigurisht me mbështetjen e Ministrisë dhe institucioneve kompetente në vend. “Në fushën e përmirësimit të statusit dhe standardit të jetesës, Ministria e Mbrojtjes i jep mbështetjen maksimale të plotë çdo pjesëtarit që të ndihet krenar për punën e tij”, tha gjenerali.

Lidhur me projektin për sigurimin e ushqimit për të gjithë Armatën, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm theksoi se ky projekt ka qenë një domosdoshmëri në 30 vitet e fundit dhe se me mbështetjen e Ministrisë, zbatimi i tij mund të fillojë në fillim të vitit 2022.

Dukuri të artit ushtarak të shfaqura në Luftën e Dibrës 1920-1921

(Në kuadrin e 100-vjetorit të përfundimit të Luftës së Dibrës)



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Lufta e Dibrës në sfondin historik

Në Luftën e Dibrës morën pjesë pothuajse të gjitha forcat e grupet shoqërore të popullsisë. Lufta mori karakterin e një lufte balllore, që dëshmonte për ndryshime në përmasa, në organizim të veprimeve luftarake, si dhe të disa dukurive të shfaqura të artit ushtarak shqiptar. U krijua kështu një front i gjerë lufte kundër ushtrisë serbe, që përbënte dhe tiparin kryesor të saj.

Në udhëheqje të Luftës së Dibrës dolën përfaqësues të patriotizmit, njerëz fisnikë, të kamur në pasuri, drejtues të organizimeve ushtarake, si dhe atdhetarë të qytetit dhe të fshatit. Kjo dukuri në udhëheqje, organizim, drejtim dhe plotësime të tjera të detyrave luftarake çlirimtare, përbënte një tipar të ri, që dëshmonte për zhvillimet cilësore të ndodhura në ndryshimin e luftës së armatosur.

Ndryshime u vunë re dhe në aspektin organizativ të kësaj lufte. Dolën në skenë forma organizative demokratike. U organizuan kuvende, mbledhje, pleqësi dhe kuvendime me luftëtarët, disa prej këtyre formave kishin qenë dhe më parë, por morën një përmbajtje të re. Shpejt lëvizja e kapërceu karakterin e ngushtë lokal dhe mori karakter përbashkues ndërkrainor.

Tipar dallues i Luftës së Dibrës ishte masiviteti dhe vullnetarizmi. Luftëtarët u organizuan në çeta. Parimi i pjesëmarrjes ose i mobilizimit për luftë ishte vullnetarizmi që mbështetej në zakonet dhe traditat popullore, sipas të cilëve "çdo derë" (shtëpi) nxirrte nga një luftëtar. Çdo njësi e banuar, fshat, lagje qytet, krahinë etj., do të nxirrte çetën e grupit të vet me një numër përafërsisht të përcaktuar luftëtarësh. Zakoni po merrte formën e detyrimit të pakundërshtueshëm. Mobilizimi i forcave kryengritëse u bë mbi baza vullnetare.

Tiparet që u manifestuan gjatë organizimit

Si rregull, para nisjes së luftës mbledhesh një kuvend krahinor ose ndërkrainor i cili shpallte vendimet dhe përcaktonte qëllimin dhe etapat përkatëse të luftës, masat organizative, detyrat, numrin e forcave dhe detyrimin për çdo fshat e krahinë, zgjidhte prijësit apo drejtuesit e luftës. Komanda ushtarake, nën drejtimin e Elez Isufit, analizoi gjendjen e forcave armike dhe caktoi zonën e luftimeve për çdo çetë për sulm ose



Lufta Ballkanike

në prapavijë të armikut. Ushtria serbe që vendosur në pikat më dominuese të krahinës.

Ushtria serbe ishte e fortifikuar në transhe të thella, pozicionet (nozullimet) ishin futur në tokë dhe pozicionet kryesore ruheshin nga disa prita të avancuara në pararojë dhe praparojë të tyre. Në pika dominuese ishin vendosur dhe topa me rreze veprimi të gjatë. Marrja e këtyre pozicioneve ishte vendimtare për kryengritjen, prandaj dhe sulmet u studiuan dhe u përgatitën me shumë kujdes. U vendos që të sulmoheshin natën pikat e avancuara sepse kështu i afroheshin fshehurazi sa më shumë objektivit.

Luftëtarët duke i mashtruar serbët me sulme fiktive, me britma të fuqishme "o besa besë" e me të shtëna me armë iu afruan shumë pozicioneve armike. Zjarri i armikut ishte shumë i dendur, si dhe terreni mjaft i disfavorshëm, megjithatë sulmuesit, nuk e ndalën përparimin e tyre drejt llogoreve armike.

Në shumë pika u kalua në luftim trup me trup me armikun brenda llogoreve të tij. Ushtrinë serbe e zë paniku dhe u vu në ikje pasi la të vvarë, të plagosur dhe të kapur rob. Trimëri të jashtëzakonshme tregoi luftëtari Osman Tahir Paci, i cili ra dëshmor.

Faktori moral, si faktori tradicional i popullit shqiptar në të shkuarën, u shpreh në një shkallë më të lartë dhe u materializua në gatishmërinë e popullit kryengritës, në forcën shpirtërore për të duruar të gjitha privacionet e luftës, në vendosmërinë për të luftuar me një armik mjaft të madh në forca e mjete e në heroizmin masiv u bë faktori themelor i fitores. Epërsia e faktorit moral të forcave kryengritëse ndikoi edhe në thellimin e mëtejshëm të krizës morale të forcave pushtuese. Ky faktor i

rëndësishëm kompensoi në një shkallë të caktuar edhe inferioritetin në forca e mjete të forcave kryengritëse dhe u siguroi atyre fitoren në fushën e luftës së armatosur. Lufta e Dibrës dëshmoi edhe një herë vlerën morale se luftën nuk e fitojnë ata që kanë shumë armë, topa dhe vegla të luftës.

Nga ana taktike, kryengritësit zbatuan me sukses sulmet e rrufeshme, goditjen natën, tërhoqën vëmendjen e armikut me sulme fiktive dhe vepruan njëkohësisht edhe në prapavijet e armikut, si brenda kufirit të 1913-ës edhe jashtë këtij kufiri për qëllime zbulimi. Kryengritësit shqiptarë vendosën lidhje me forcat e armatosura maqedonase, të cilët kundërshtonin politikën serbomadhe.

Strategjia ushtarake dhe organizimi ushtarak

Mësymja në përgjithësi filloi nga rajonet malore dhe u drejtua mbi garnizone dhe qendra të vogla, sipas vendimit të kuvendit, çetat dhe forcat luftarake u nisën në drejtimin e objektivit të mësymjes sikurse ishin përforcimet serbe. Luftëtarët iu afruan objektit në kolona marshimi dhe rreth 2 km pranë objektit të sulmit, ndalonin në vende të maskuara. Këtu pas njohjes me terrenin dhe objektivat, përcaktuan detyrën luftarake për luftim dhe kohën e kalimit në sulm me sinjale. Sulmet zakonisht ishin rrethore dhe të vrullshme mbi garnizonin. Brenda ditës luftimet ishin të përfunduara dhe me fitore të forcave kryengritëse.

Mbrojtja zakonisht fillonte kur luftëtarët kishin kapur pozicione të rëndësishme taktike dhe deri operative dhe ishin afër rajoneve të fortifikuara. Mbrojtja e luftëtarëve u karakterizua gjithmonë nga manovra e shpejtë dhe krahëmarrëse. Pikënisja e luftimeve ishte ndeshja në një vijë dhe pozicion

të caktuar terreni, ku luftëtarët organizuan mbrojtje, prita dhe kurthe.

Forcat kryengritëse kalonin në mësymje dhe duke realizuar objektivat operative me metodat taktike, me goditje të njëpasnjëshme, e nga disa drejtime, duke shfrytëzuar sistemin e mbrojtjes armike të përbërë nga garnizone të veçuara, me largësi ndërmjet tyre, si dhe duke përfutur nga karakteri i thyer i terrenit.

Në rezultat të pushtimit të garnizoneve ushtarake fortifikuese, kur armiku u përqendrua, forcat kryengritëse duke e njohur armikun, në forca e mjete dhe në mbrojtjen e fortifikuar, u përqendruan në mënyrat e sulmit mbi objektet e fortifikuara. Objektivat u arritën duke gërshtuar drejt sulmet e vazhdueshme me karakter shqetësues, rraskapitës e demonstrativ, me veprime mësymëse të të gjitha çetave në kushtet e luftës frontale për shpërthimin e rajoneve të fortifikuara. Në këtë mënyrë u shmang luftimi pozicional, u përdorën metoda aktive, dinamike që ndikuan në kompensimin në forca e mjete të luftëtarëve, i dhanë luftës karakter vendimtar duke çuar në shpartallimin e armikut superior dhe çlirimin e Peshkopisë dhe të Dibrës.

Realizimi i disa masave të mas-kimit, si një nga tiparet e artit taktik, bëri që lëvizja e çetave në fshehtësi dhe shpejtësi, të ishte parësore në drejtim. Risi e re ishte kalimi i pengesave, i transheve dhe i luftimeve trup me trup. Masa luftarake të marra nga njëra anë, si dhe qëndrimi në pozicione të ushtrisë serbe, e vunë komandën serbe përballë të papriturave duke u bërë faktor i rëndësishëm për suksesin.

Çështja e furnizimit me ushqime e materiale të tjera luftarake ishte një ndër problemet e ndërlikuara që u zgjidhën në luftë e sipër. Duke vlerë-

suar kushtet e vështira të furnizimit, u përcaktua si e vetmja zgjidhje, mbështetja në forcat e çdo fshati për çetën e vet. Burim kryesor i furnizimit u bënë fshatrat e Dibrës. Masa e gjerë e fshatarësisë, megjithëse mjaft e varfër, vunë në dispozicion të forcave kryengritëse të gjitha sendet e nevojshme ushqimore, blegtorale e bujqësore e siguruan ndihma të konsiderueshme dhe për mjaft materiale të tjera. Burim shumë i rëndësishëm për furnizimi u bë dhe armiku, sidomos për armatim e municion. Sigurimi i armatimit duke ia rrëmbyer armikut në fushën e luftës, ishte një nga objektivat kryesore të planit të komandës së forcave kryengritëse, veçanërisht gjatë fazën e parë të luftës, i cili u realizua me shumë sukses dhe i përmirësoi në mënyrë të ndjeshme kushtet e armatimit të forcave kryengritëse.

Taktika e luftimit përdori forma e metoda origjinale që u mbështetën në traditën e pasur luftarake të popullit dhe që u mbajtën parasysh në format e organizimit ushtarak e shkallën e pajisjes me teknikë luftarake të forcave kryengritëse. Forcat kryengritëse gërshtuan drejt taktikën e luftës në front të rregullt me format e metodat e luftës tradicionale. Taktika u shqua nga aktiviteti, dinamizmi dhe shpirti sulmues. Nëpërmjet goditjeve të befasishme, sulmeve natën, vendosmërisë në luftim, manovrueshmërisë e shfrytëzimit të terrenit, përdorimit me shpirt krijues i mjeteve rrethanore, etj., Forcat Kryengritëse kapërcyen pengesat me tela, shpërthyen pozicionet e fortifikuara dhe zgjidhën detyra të vështira në luftim. U bënë veçori e taktikës sulmet e pandërprera me forca të kufizuara, që nuk i lanë forcat serbe të merrnin frymë, i mbajtën në panik e në tension të vazhdueshëm nervor dhe u siguruan forcave kryengritëse iniciativën. Në Luftën e Dibrës, përdorim të gjerë morën veprimet luftarake mësymëse, por në momente të caktuara u përdorën dhe luftimet mbrojtëse. Taktika e luftimeve mbrojtëse u karakterizua gjithashtu nga qëndrueshmëria, aktiviteti, ndërtimi i kurtheve, pritave etj.

Lufta e Dibrës tregoi vitalitetin dhe energjinë luftarake të një populli që u ngrit në këmbë për të mbrojtur me gjak lirinë dhe pavarësinë e vet. Kjo luftë u bë një thesar i paçmuar i traditave luftarake të tij, që u trashëgua e u ngrit në një shkallë të lartë nga formacionet partizane në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Këto tradita, kjo përvojë duhet të mësohen e të njihen nga ushtarakët e të gjitha strukturat e sigurisë në interes të rritjes së aftësive luftarake e të përdorimit me mjeshtëri në fushën e luftës të formave e metodave të luftimit sa më të gjalla e më të larmishme.

10 marinat më të fuqishme në botë

Gazeta "Ushtria do të botojë në numrat e ardhshme marinat më të fuqishme në botë"

Disa dekada më parë, marina e Koresë së Jugut ishte pak e njohur. Megjithatë kohët e fundit ajo u shndërrua nga një forcë bregdetare në një forcë të aftë për të lundruar në oqean. Aktualisht ka 70 000 personel.

Marina e Koresë së Jugut nuk ka asnjë aeroplanmbajtëse. Sidoqoftë, ekziston një anije e vetme sulmi amfibe e klasit "Dokdo". Për nga madhësia është e ngjashme me aeroplanmbajtëset e lehta.

Ka 3 shkatërrues (destroyer) raketash të drejtuar të klasit "Sejong the Great". Këto janë ndër anijet luftarake më të avancuara sot. Aktualisht këta janë shkatërruesit më të aftë në botë pas klasit amerikan "Zumwalt". Anijet e klasit "Sejong the Great" mbajnë një sërë raketash dhe janë të afta për të përballuar pothuajse çdo kërcënim në det, në tokë ose në ajër. Për sa i përket zhvendosjes dhe armatimit, këto anije luftarake janë më afër kryqëzorëve. Gjithashtu ka 6 shkatërrues shumë-funksional të klasit "Chungmugong Yi Sun-sin" dhe 3 shkatërrues të klasit "Kwanggateo the Great" (megjithëse disa i referohen këtyre anijeve luftarake si fregata).

Në marinën e Koresë së Jugut ekziston një fregatë e vetme aktive e mbrojtjes ajrore e klasit "Daegu", e cila është vënë në punë në vitin 2018. Tre anije luftarake të tjera të



Marina e Koresë së Jugut

këtij klasi janë në ndërtim e sipër. Gjithashtu ka 6 fregata mbrojtëse bregdetare të klasit "Incheon". Marina e Koresë së Jugut operon 6 fregata të vjetra të klasit "Ulsan", të cilat janë vënë në punë midis fillimit të viteve 1980 dhe fillimit të viteve 1990, megjithëse këto anije të vjetra

janë planifikuar të çaktivizohen në të ardhmen e afërt.

Marina e Koresë së Jugut operon 7 nëndetëse gjermane të tipit 214 (të njohura në vend si klasi "Sohn Won-yil"), me naftë me sistem shtytës të pavarur. Gjithashtu ka 9 nëndetëse më të vjetra të klasit "Chang Bogo" me naftë.

Trupat Detare të Koresë së Jugut janë modeluar sipas Korpusit të Marinave të SHBA-së dhe kanë rreth 29 000 personel. Në rast lufte, këto forca mund të vendosen në territorin e Koresë së Veriut dhe në ishuj të tjerë. Ka 2 anije zbarkimi amfibe aktive të klasit "Cheong Wang Bong". Dy anije

të tjera të këtij klasi janë në ndërtim e sipër. Gjithashtu ka 4 anije zbarkimi amfibe të klasit "Go Jun Bong".

Aviacioni detar i Koresë së Jugut ka rreth 70 avionë. Shumica e këtyre janë në fakt helikopterë. Megjithëse ka 16 avionë patrullimi detar "Lockheed Martin P-3C Orion".



FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

